

Përmbledhje

- **Ekonomia e eurozonës, sipas Eurostat-it, ka shënuar rritje vjetore të ngadalësuar prej 0.6 përqind në TM2 2024, dhe rritje prej 0.2 përqind kundrejt tremujorit paraprak.** Banka Qendrore Evropiane (BQE) ka projektuar një rritje ekonomike prej 0.8 përqind për vitin 2024 dhe 1.3 përqind për vitin 2025. Shkalla e inflacionit në TM2 2024 ka arritur në 2.5 përqind, duke shënuar rënie të dukshme krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (6.2 përqind në TM2 2023). Projektionet e BQE-së sugjerojnë për ngadalësim të inflacionit në 2.5 përqind në 2024 dhe 2.2 përqind në vitin 2025.
- Ekonomia e Kosovës shënoi rritje prej 4.9 përqind në gjysmën e parë të vitit 2024, e mbështetur nga rritja e konsumit dhe investimeve, përderisa eksportet neto ndikuan negativisht. **Vetëm gjatë TM2 2024, aktiviteti ekonomik u rrit me 4.3 përqind, falë rritjes së konsumit për 5.9 përqind dhe investimeve për 3.0 përqind, ndërsa deficitit tregtar u thellua për 7.7 përqind.** Në gjysmën e dytë të vitit, vlerësohet se rritja e aktivitetit ekonomik ishte më e ngadalësuar, për shkak të rritjes më të ulët të treguesve kyç që lidhen me aktivitetin ekonomik, si remitencat, IHD-të, konsumi publik dhe investimet publike, etj. Viti 2024 pritet të përmbyllet me rritje prej 4.3 përqind të aktivitetit ekonomik, që do të jetë pak më e lartë krahasuar me vitin e kaluar, kur rritja ishte 4.1 përqind. Megjithatë, pasiguritë mbeten të larta për shkak të rritjes së ngadalësuar të ekonomisë botërore dhe tensioneve gjeopolitike.
- **Inflacioni në TM2 2024 u përshpejtua në 2.4 përqind nga 2.1 përqind në tremujorin paraprak.** Kontributi kryesor në përshpejtimin e inflacionit u shënuar nga rritja vjetore e çmimeve të naftës, kurse kontributi nga ushqimi, shërbimet, dhe mallrat tjera mbeti pothuajse i pandryshuar kundrejt tremujorit paraprak. Përshpejtim u evidentua edhe në inflacionin bazë, kryesisht nga rritja e çmimeve të shërbimeve të transportit.
- **Në TM2 2024, të hyrat primare buxhetore arritën në 735.9 milionë euro, me një rritje prej 7.8 përqind. Shpenzimet primare u rritën për 4.8 përqind, duke arritur në 649.1 milionë euro, dhe si rezultat, u shënuar bilanc pozitiv prej 86.8 milionë euro.** Të hyrat tatimore shënuan rritje prej 4.5 përqind, me tatimet indirekte që u rritën për 6.8 përqind, ndërsa të hyrat jo-tatimore u rritën për 42.1 përqind. Shpenzimet për paga u rritën për 18.8 përqind, ndërsa shpenzimet kapitale shënuan rënie prej 0.9 përqind. Raporti i borxhit publik ndaj BPV-së ra në 15.8 përqind, duke arritur në 1.66 miliardë euro, një rënie prej 0.7 përqind krahasuar me TM2 2023.
- **Llogaria rrjedhëse në TM2 2024 u karakterizua me rritje të deficitit prej 16.3 përqind duke arritur vlerën prej 372.3 milionë euro.** Dinamikat në llogarinë rrjedhëse në TM2 2024 kanë vazhduar të përcaktohen kryesisht nga zhvillimet në bilancin tregtar të mallrave. Remitencat, si një ndër burimet më të rëndësishme të financimit të konsumit, shënuan rënie prej 2.0 përqind, duke arritur vlerën prej 349.0 milionë euro. Ndërsa, investimet e huaja direkte shënuan rritje prej 8.6 përqind dhe arritën vlerën prej 204.0 milionë euro.
- **Spektori bankar** ka vazhduar zgjerimin në shkallë dyshifrore, por me ritëm më të ngadalësuar krahasuar me gjysmën e parë të vitit paraprak. Ky zhvillim në asetet e sektorit mund të i atribuohet pjesërisht rritjes më të ngadalësuar të depozitave si burim kryesor i financimit, por dhe kërkesës relativisht më të ulët për kredi nga korporatat jofinanciare, përderisa kreditimi për ekonomitë familjare u përshpejtua dhe dha kontributin kryesorë në rritjen e aktivitetit kreditues. Bankat kanë ruajtur një bazë të fortë të kapitalit, likuiditetit të lartë dhe cilësi kreditore të mirë. Investimet në letrat me vlerë u rritën, duke përfutur nga normat ende të larta të interesit, pavarësisht uljes së normës bazë nga BQE-ja.
- **Spektori pensional** u karakterizua me rritje vjetore të përshpejtuar të aseteve, ndikuar nga kthimi pozitiv në investime si rezultat i përmirësimit deri në një masë të treguesve makroekonomik global, si dhe rritjes së kontributeve të arkëtuara gjatë kësaj periudhe.
- **Asetet e sektorit të sigurimeve** kanë vazhduar trendin e rritjes, ndonëse me ritëm më të ngadalësuar se në vitin paraprak. Përderisa të hyrat e sektorit dhe profiti shënuan rritje të përshpejtuar vjetore, treguesit e qëndrueshmërisë së sektorit dhe treguesit e likuiditetit shënuan rënie të lehtë nga gjysma e parë e vitit paraprak.
- **Spektori mikrofinanciar** ka shënuar rritje të lartë të aseteve, ndikuar kryesisht nga rritja e aktivitetit kreditues. Profitabiliteti i sektorit po ashtu shënoi rritje të theksuar për dallim nga viti paraprak, ndërsa kreditë jo-performuese dhe niveli i likuiditetit shënuan rënie të lehtë.

Lista e shkurtesave

ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQE	Banka Qendrore Evropiane
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
EUR	Valuta Euro
FAO	Food and Agriculture Organization (Organizata për Ushqim dhe Bujqësi)
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
IÇIMP	Indeksi i Çmimit të Importit
IÇK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit
IHD	Investimet e Huaja Direkte
KJF	Korporatat jo-financiare
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve e Republikës së Kosovës
MMBTU	Metric Million British Thermal Unit
WEO	World Economic Outlook

Përmbajtja

Përmbledhje	i
1. Eurozona dhe Ballkani Perëndimor	3
2. Çmimet e mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare	4
3. Ekonomia e Kosovës	6
3.1. Rritja Ekonomike	6
3.2. Çmimet	Error! Bookmark not defined.
3.3. Sektori Fiskal	9
3.4. Sektori i jashtëm	10
4. Sistemi financiar	Error! Bookmark not defined.
4.1. Sektori bankar	14
4.2. Sektori pensional	14
4.3. Sektori i sigurimeve	24
4.4. Sektori mikrofinanciar	26
4.5. Tregu i letrave me vlerë i Qeverisë së Republikës së Kosovës	29

1. Eurozona dhe Ballkani Perëndimor

Ekonomia e Eurozonës, sipas Eurostat, shënoi rritje vjetore prej 0.6 përqind, dhe rritje tremujore prej 0.2 përqind në TM2 2024. Kontributin kryesor në këtë rritje e kishte eksporti neto, që kontribuoi me 0.5 pikë përqindje, duke reflektuar përmirësimin e bilancit tregtar dhe rritjen e kërkesës së jashtme për mallrat dhe shërbimet e Eurozonës. Konsumi publik kontribuoi me 0.1 pikë përqindje, ndërsa konsumi privat mbeti i pandryshuar, duke kontribuar me 0.0 pikë përqindje për shkak të pasigurisë ekonomike dhe çmimeve ende të larta. Ndërkohë, formimi i bruto kapitalit ndikoi negativisht me 0.5 pikë përqindje.


Gjermania, si ekonomia më e madhe e Eurozonës, shënoi tkurrje prej 0.1 përqind kundrejt tremujorit paraprak dhe stagnim kundrejt periudhës së njëjtë të vitit të kaluar, kryesisht për shkak të rënies së konsumit privat dhe investimeve në ndërtim. **Projeksionet e BQE-së për rritjen ekonomike janë rishikuar për poshtë me -0.1 pikë përqindje në shtator 2024 kundrejt projeksioneve të qershorit 2024, në një rritje të parashikuar ekonomike prej 0.8 përqind për vitin 2024 dhe 1.3 përqind për vitin 2025.** Megjithë performancën e dobët këtë tremujor, projeksionet sugjerojnë se mbështetur nga rritja e të ardhurave të disponueshme në ekonomi me stabilizimin e inflacionit dhe rritjen e pagave, konsumi privat pritet të mbetet mbështetës kryesor i rritjes ekonomike.

Inflacionit në TM2 2024 arriti në 2.5 përqind, duke shënuar rënie të dukshme nga 6.2 përqind në TM2 2023. Projeksionet e BQE-së sugjerojnë se inflacioni do të ngadalësohet në 2.5 përqind në vitin 2024 dhe 2.2 përqind në vitin 2025. Megjithatë, dinamikat e inflacionit mund të ndikohen nga tensionet gjeopolitike, veçanërisht në Lindjen e Mesme, duke u reflektuar potencialisht në çmimet e energjisë dhe kostot e mallrave.

Për herë të parë në nëntë muaj, në qershor 2024, BQE uli normat referente me 25 pikë bazë, si rezultat i përmirësimit të prospektive për dinamikat e inflacionit dhe rënien shkallës së inflacionit përgjatë vitit. Deri në tetor 2024, normat bazë të interesit u ulën tre herë, duke reflektuar përpjekjet për të ruajtur stabilitetin financiar dhe balancuar rritjen ekonomike. Norma e interesit për depozita ra në 3.25 përqind nga 4.00 përqind, norma për operacionet e ri-financimit u ul në 3.40 përqind nga 4.50 përqind, dhe norma margjinale për huadhënie u ul në 3.65 përqind nga 4.75 përqind.

Në Ballkanin Perëndimor, mesatarja e rritjes ekonomike në TM2 2024 ishte 3.3 përqind, me rritjen më të lartë të shënuar në Kosovë prej 4.3 përqind, ndërsa rritjen me të ulët të shënuar në Bosnjë dhe Hercegovinë me 2.2 përqind (grafiku 1). Rritja u mbështet nga konsumi dhe investimet, ndërsa pasiguria ekonomike dhe tensionet gjeopolitike mbeten sfida për stabilitetin e rajonit. Po ashtu, rritja e ngadalësuar e aktivitetit ekonomik në vendet e BE-së si partner i rëndësishëm tregtar, së bashku me sfidat e brendshme si përballja me çmimet e rritura dhe migrimin, paraqesin sfida të vazhdueshme për ruajtjen e rritjes ekonomike në rajon. **Projeksionet e FMN-së, të realizuara në tetor 2024, sugjerojnë se vendet e Ballkanit Perëndimor pritet të shënojnë rritje mesatare ekonomike prej 3.2 përqind në vitin 2024 dhe 3.6 përqind në 2025.**

Grafik 1. Rritja ekonomike dhe inflacioni në vendet e Ballkanit Perëndimor (TM2 2024)



Burimi: Agjencitë Statistike përkatëse.

Shkalla mesatare e inflacionit në TM2 2024 ishte 3.3 përqind, me shkallën më të lartë të shënuar në Mal të Zi prej 4.8 përqind, ndërsa Bosnja dhe Hercegovina ka shënuar normën më të ulët të inflacionit prej 1.9 përqind.


Në TM2 2024, euro u vlerësua ndaj lirës turke dhe frangut zviceran kundrejt tremujorit paraprak, ndërsa u zhvlerësua ndaj lekut shqiptar, dollarit amerikan, sterlinës britanike dhe denarit maqedonas.

2. Çmimet e mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare

Çmimet e mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare shënuan rritje në TM2 2024. Indeksi i çmimeve të mallrave bazë, sipas Bankës Botërore, shënoi rritje mesatare prej 4.0 përqind në TM2 2024 kundrejt tremujorit paraprak dhe 4.7 përqind krahasuar me TM2 2023. Kjo rritje u diktua kryesisht nga çmimet e energjisë, pijeve, metaleve dhe mineraleve. Presionet inflacioniste ishin më të theksuara në prill, si pasojë e rritjes së çmimeve të naftës, ndërsa u zbehën në dy muajt pasues. Në terma vjetorë, çmimet e mallrave bazë vlerësohet të kenë shënuar rënie në vitin 2024, ecuri që pritet të vazhdojë edhe në dy vitet në vijim. Parashikimet, sidoqoftë, janë subjekt i rreziqeve të mundshme që vazhdojnë të anojnë nga kahu i lartë, si tensionet gjeopolitike dhe goditjet e mundshme në ofertë, kushtet klimatike, barrierat tregtare, e të tjera.

Çmimet e naftës së papërpunuar brent, sipas Bankës Botërore, arritën mesatarisht \$84.9 për fuçi në TM2 2024, që paraqet rritje prej 8.5 përqind kundrejt periudhës korresponduese të vitit paraprak (grafik 1). Çmimet e naftës shënuan rritje edhe në raport me tremujorin paraprak, si pasojë e intensifikimit të tensioneve gjeopolitike në Lindjen e Mesme kundrejt një sfondi me ofertë të reduktuar nga OPEC+ dhe sinjale për përmirësim të aktivitetit industrial global. Megjithatë, kjo rritje ishte afatshkurtër, pasi çmimet ranë nga \$90 për fuçi në prill në mesatare prej \$82.3 për fuçi në dy muajt vijues, kryesisht si rezultat i zhvillimeve në konfliktin në Lindjen e Mesme dhe rritjes së rezervave të naftës. Sipas parashikimeve të Bankës Botërore, çmimet e naftës do të arrijnë mesatare vjetore prej \$80 për fuçi në vitin 2024 dhe mund të bien në \$73 për fuçi në vitin 2025, për shkak të pritjeve për rritje të prodhimit nga OPEC+ pas heqjes së reduktimeve të prodhimit, përmirësimit të zinxhirëve të furnizimit dhe ngadalësim të kërkesës globale për naftë. Rreziku më i madh për çmimet e naftës mbeten tensionet gjeopolitike, të cilat mund të shkaktojnë luhatje të papritura të çmimeve.


Grafik 1. Çmimet e naftës dhe gazit natyror në tregjet ndërkombëtare



Burimi: Banka Botërore.

Çmimet e gazit natyror në Evropë në TM2 2024 rezultuan në mesatare prej \$10.0/mmbtu, që paraqet rënie vjetore prej 11.5 përqind, si rezultat i stabilizimit të çmimeve pas ri-konfigurimeve në zinxhirët e furnizimit dhe rritjes së rezervave të gazit natyror në Evropë (grafik 1). Megjithatë, kundrejt tremujorit paraprak, çmimet e gazit natyror në Evropë shënuan rritje prej 14.5 përqind, duke vazhduar trendin e rritjes që ishte evidentuar në fundin e tremujorit të mëparshëm. Kjo rritje po ashtu ishte e lidhur me shqetësimet për sigurinë e furnizimit në Evropë, tensionet gjeopolitike dhe reduktimet në furnizim, si dhe rritjen e konkurrencës globale për eksportet e gazit natyror të lëngëzuar (LNG) nga SHBA-të. Sipas Bankës Botërore, çmimet e gazit natyror në Evropë pritet të arrijnë mesatare vjetore prej \$10.8/mmbtu në 2024 dhe të ngriten në \$11.5/mmbtu në vitin 2025, bazuar në pritjet për rritje të kërkesës industriale, si rezultat i çmimeve më të ulëta të gazit.

Grafik 2. Indeksi i metaleve dhe mineraleve dhe metaleve të çmuara




Burimi: Banka Botërore.

Indeksi i çmimeve të metaleve dhe mineraleve qëndroi për 9.3 përqind më lart krahasuar me periudhën përkatëse të vitit paraprak, me të gjitha kategoritë e metaleve dhe mineraleve që shënuan rritje vjetore, përveç nikelit (grafiku 2). Rritja e çmimeve të metaleve reflekton pritjet për përmirësim të kërkesës globale, si dhe shqetësimet rreth sigurisë së ofertës si pasojë e barrierave tregtare dhe pengesave tjera. Indeksi i çmimeve të metaleve dhe mineraleve shënoi rritje prej 11.3 përqind kundrejt tremujorit paraprak, diktuar nga rritja e çmimeve të bakrit dhe aluminit, ndërkohë që çmimet e xehes së hekurit shënuan rënie. Çmimet e metaleve industriale pritet të mbesin të qëndrueshme, me rritjen e aktivitetit industrial global që pritet të kompensojë rënien e kërkesës nga sektori i ndërtimit në Kinë.

Indeksi i çmimeve të metaleve të çmuara vijoi të ndjekë ecuri rritëse përgjatë TM2 2024, duke shënuar rritje prej 5.5 përqind kundrejt tremujorit paraprak dhe duke qëndruar për 27.7 përqind më lartë krahasuar me TM2 2023. Çmimet e arit dhe argjendit shënuan rritje vjetore prej 28.6 dhe 24.9 përqind respektivisht, nxitur nga rritja e kërkesës për ari nga disa banka qendrore dhe si pasojë e tensioneve gjeopolitike, duke e bërë atë një instrument të sigurt për ruajtjen e vlerës së parasë. Çmimet e metaleve të çmuara pritet të mbeten të larta edhe në vitin 2025, marrë parasysh tensionet e ngritura gjeopolitike.

Indeksi i çmimeve të ushqimit në TM2 2024, sipas FAO-s, shënoi rënie vjetore prej 4.1 përqind kundrejt periudhës korresponduese të vitit paraprak (grafiku 3). Kjo rënie reflekton rënien vjetore të çmimeve të drithërave dhe sheqerit, si rezultat i përmirësimit të prodhimit dhe kushteve të favorshme klimatike në vendet eksportuese. Megjithatë, kundrejt tremujorit paraprak, indeksi i çmimeve të ushqimit shënoi rritje prej 2.0 përqind, pas një viti me rënie të vazhdueshme në terma tremujorë. Kjo rritje u diktua kryesisht nga çmimet e mishit, bulmetit, vajrave dhe drithërave, ndërsa çmimet e sheqerit vijuan të ndjekin ecuri rënëse edhe në terma tremujorë. Çmimet e ushqimit pritet të ndjekin ecuri rënëse përgjatë vitit 2025, bazuar në pritjet për stabilizim të mëtutjeshëm të ofertës.

Grafik 3. Indeksi i çmimeve të ushqimit



Burimi: FAO.

3. Ekonomia e Kosovës

3.1. Rritja Ekonomike


Ekonomia e Kosovës është karakterizuar me përmirësim të kushteve makroekonomike në gjysmën e parë të vitit 2024. Sipas vlerësimeve të ASK-së, BPV reale ka shënuar rritje prej 4.9 përqind, e mbështetur nga rritja e konsumit dhe investimeve, ndërsa eksportet neto ndikuan negativisht aktivitetin ekonomik. Megjithatë, në gjysmën e dytë të vitit, vlerësohet se rritja ekonomike ishte më e ngadalësuar krahasuar me gjysmën e parë, për shkak të rritjes më të ulët të treguesve kyç që lidhen me aktivitetin ekonomik, si remitencat, IHD-të, konsumi publik dhe investimet publike, etj. Viti 2024 pritet të përmbyllet me një rritje ekonomike prej 4.3 përqind, me kontribuues kryesor konsumin, investimet dhe eksportin e mallrave dhe shërbimeve, ndërsa importi i mallrave dhe shërbimeve pritet të ketë ndikim negativ në rritjen e BPV-së. Përveç burimeve të financimit, rritja pritet të mbështete gjithashtu nga ulja e inflacionit dhe nga efektet pozitive të mundshme në kushtet e brendshme të financimit, si rezultat i lehtësimit të politikës monetare në eurozonë. Sidoqoftë, pasiguritë mbeten të larta për shkak të rritjes së dobët të ekonomisë së eurozonës dhe tensioneve gjeopolitike.

Gjatë TM2 2024, ekonomia e Kosovës ka shënuar rritje prej 4.3 përqind (grafiku 4). Ky përshejtimi i rritjes ekonomike në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar lidhet kryesisht me dinamikën e kërkesës vendore. Megjithatë, eksportet neto ndikuan negativisht aktivitetin ekonomik, për shkak të rritjes së kërkesës vendore që u shoqërua me rritje të importit, liberalizimit të vizave dhe efekteve në rritjen e importit të shërbimeve, dhe faktorëve tjerë global siç janë çmimet në tregjet ndërkombëtare dhe kërkesa e dobësuar në Eurozonë.

Gjatë këtij tremujori, konsumi është rritur për 5.9 përqind, duke shënuar një rritje të konsiderueshme krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit të kaluar. Kjo rritje është mundësuar nga rritja e burimeve të financimit, përfshirë rritjen e kredive konsumuese, kompensimit të punëtorëve dhe rritjen e konsumit publik, ndërsa remitencat shënuan rënie të lehtë. Investimet shënuan rritje për 3.0 përqind, kryesisht si rezultat i rritjes së IHD-ve dhe kreditimi, ndërkohë që edhe importi i mallrave kapitale ka shënuar rritje të konsiderueshme. Sa i përket tregtisë së jashtme, deficitit tregtar është thelluar për 7.7 përqind, si rezultat i rritjes së importit të mallrave për 5.5 përqind dhe importit të shërbimeve për 17.8 përqind, ndërsa eksporti i mallrave dhe shërbimeve shënoi rritje për 10.7 përkatësisht 6.8 përqind.


Rritja e aktivitetit ekonomik në TM2 2024 është mbështetur kryesisht nga rritja e vlerës së shtuar në sektorin e furnizimit me energji elektrike dhe gaz (25.3 përqind), informimit dhe komunikimit (4.2 përqind), industrisë

Grafik 4. Rritja reale e BPV-së



Burimi: ASK dhe llogaritjet e BQK-së.

Grafik 5. Numri i ndërmarrjeve të reja



Burimi: ASK.


përpunuese (3.8 përqind), hoteleve dhe restoranteve (3.8 përqind), tregtisë (3.7 përqind), industrisë nxjerrëse (2.3 përqind) dhe aktiviteteve financiare dhe të sigurimit (2.2 përqind).

Kjo dinamikë ekonomike ka pasur gjithashtu ndikim në rritjen e numrit të ndërmarrjeve të regjistruara, duke arritur në 2,815 ndërmarrje të reja në TM2 2024, një rritje prej 5.7 përqind krahasuar me TM2 2023. Sektorët e prodhimit, tregtisë, ndërtimit, transportit dhe bujqësisë kanë regjistruar numrin më të madh të ndërmarrjeve të reja, duke reflektuar rritje të ndjeshme krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2023 (grafiku 5). Gjithashtu, gjatë TM2 2024, numri i ndërmarrjeve të mbyllura shënoi rënie për 9.7 përqind krahasuar me TM2 2023, duke arritur në 355 ndërmarrje.

3.2. Çmimet

Inflacioni në TM2 2024 shënoi rritje mesatare vjetore prej 2.4 përqind, duke u përshpejtuar nga 2.1 përqind sa ishte në tremujorin paraprak. Rritja e çmimeve të naftës në tregjet ndërkombëtare u reflektua zbehtë në çmimet e naftës në vend në prill, megjithatë baza e ulët krahasuese ndikoi që çmimet e karburanteve të rezultojnë në nxitësin kryesor të përshpejtimit të inflacionit në TM2 2024. Çmimet e ushqimit dhe shërbimeve mbetën të qëndrueshme duke vazhduar të kontribuojnë pozitivisht në inflacion. Ngjashëm, kontribut pozitiv vazhdoi të shënohet edhe nga çmimet e mallrave tjera që shënuan ngadalësim të lehtë të rritjes vjetore (grafiku 6).

Grafik 6. Inflacioni sipas kontributit të nëngrupeve përkatëse



Rritja vjetore e çmimeve të ushqimit mbeti pothuajse e njëjtë krahasuar me tremujorin paraprak, duke rezultuar 1.1 përqind në TM2 2024. Rritje e ngadalësuar u evidentua në çmimet e pothuajse gjysmës së shportës së ushqimit, më konkretisht në çmimet e mishit, peshkut, frutave, produkteve të sheqerit dhe atyre ushqimore; kurse, çmimet e perimeve shënuan rënie vjetore për herë të parë që nga TM1 2021. Ndonëse çmimet e bulmetit dhe vajrave vazhduan të shënojnë rënie vjetore, ritmi i ngadalësuar i rënies së çmimeve të tyre ndikoi në rritjen e kontributit pozitiv të ushqimit në inflacion. Në anën tjetër, çmimet e bukës dhe drithërave u përshpejtuan në prill dhe qershor. Sidoqoftë, ndikimi i kësaj rritje u amortizua nga dinamikat lehtësuese në çmimet e artikujve tjerë ushqimorë, duke bërë që kontributi i ushqimit në gjithsej inflacionin të mbetet i njëjtë me atë në tremujorin paraprak.

Çmimet e transportit shënuan rritje vjetore prej 2.1 përqind, që përbën përshpejtim kundrejt tremujorit paraprak kur çmimet e transportit rezultuan me rënie vjetore prej 1.8 përqind. Kjo rritje u diktua në shkallë të madhe nga rritja vjetore e çmimeve të naftës si rezultat i bazës së ulët krahasuese, dhe rritjes së çmimeve të shërbimeve të transportit.


Kontributi i ushqimit në normën mesatare të inflacionit në TM2 2024 mbeti pothuajse i njëjtë me atë në tremujorin paraprak duke rezultuar 0.4 pikë përqindje. Megjithatë, dinamikat e nënkategorive të ushqimit variuan, ku ngadalësimi i rënies së çmimeve të bulmetit reduktoi kontributin negativ të kësaj kategorie në inflacion. Mirëpo, ky ndikim u neutralizua plotësisht nga rënia e çmimeve të perimeve, ndryshime këto që u shënuan pas një periudhe me trend të qëndrueshëm rritës në çmimet e perimeve dhe rënës në çmimet e bulmetit. Kontribut pozitiv u regjistrua edhe nga rritja e çmimeve të bukës prej 0.2 pikë përqindje, frutave 0.2 pikë përqindje, sheqerit 0.1 pikë përqindje, etj. Pijet joalkoolike po ashtu kontribuan pozitivisht në inflacion me rreth 0.3 pikë përqindje, si rrjedhojë e vazhdimin të presioneve inflacioniste në këtë kategori, të cilat u ndikuan nga zhvillimet në tregjet ndërkombëtare.

Kontributi i energjisë në inflacionin e përgjithshëm në TM2 2024 u rrit në 0.5 pikë përqindje, nxitur nga rritja vjetore e çmimeve të naftës. Kontributi i çmimeve të naftës u rrit për 0.6 pikë përqindje, kurse kontributi i çmimeve të energjisë elektrike dhe lëndëve tjera djegëse u zvogëlua për 0.3 pikë përqindje, kryesisht si rrjedhojë e rënies së kërkesës për energji elektrike për ngrohje në sezonin pranveror.

Kontributi i çmimeve të mallrave tjera mbeti pothuajse i pandryshuar (0.7 pikë përqindje), i përcaktuar nga dinamika të kundërta mes çmimeve të mallrave, ngadalësimit të çmimeve dhe bazës së ulët krahasuese për artikujt të caktuar. Ngjashëm, kontributi i shërbimeve në TM2 2024 mbeti i përafërt me atë në tremujorin paraprak (0.4 pikë përqindje), me presione të lehta inflacioniste në shërbimet e transportit ndikuar nga rritja vjetore e çmimeve të naftës dhe sezonaliteti në çmimet e shërbimeve të udhëtimit ajror.


Inflacioni bazë në TM2 2024 shënoi rritje vjetore prej 3.6 përqind, duke stagneruar kundrejt tremujorit paraprak (grafiku 7). Rritja e çmimeve të shërbimeve të transportit dhe mallrave dhe shërbimeve të ndryshme u neutralizua nga ngadalësimi i çmimeve të rekreacionit dhe kulturës, mirëmbajtjes së vendbanimit, dhe kategorive tjera brenda indeksit të inflacionit bazë.

Grafik 7. Inflacioni bazë dhe inflacioni i përgjithshëm i konsumit



Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së.

Grafik 8. Inflacioni i brendshëm dhe i importuar



Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së.

Bazuar në magnitudën e importit të mallrave ushqimore dhe energjetike në Kosovë, dinamikat e inflacionit ndikohen drejtpërdrejt nga ato të çmimeve të mallrave në tregjet ndërkombëtare. Rrjedhimisht, kontributi i rritur i çmimeve të naftës në TM2 2024 u pasqyrua në rritje të inflacionit të importuar nga 1.4 në 1.9 pikë përqindje, kurse inflacioni i brendshëm u ngadalësua në 0.5 pikë përqindje duke reflektuar, ndër të tjera, rënien e çmimeve të energjisë elektrike në vend.

Indeksi i çmimeve të importit (IÇIMP) shënoi rritje vjetore prej 1.0 përqind në TM2 2024, që paraqet ngadalësim kundrejt rritjes vjetore prej 2.4 përqind në tremujorin paraprak. Krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak, kategoritë me peshën më të lartë në kuadër të këtij indeksi, që përfshijnë: i) artikujt ushqimor të përgatitur, pijet dhe duhanin, si dhe ii) mjetet e transportit shënuan rritje vjetore prej 2.5 dhe 2.8 përqind respektivisht, ndërsa iii) produktet minerale, iv) metalet bazë dhe artikujt përkatës, dhe v) pajisjet e makinerisë dhe ato elektrike shënuan rënie vjetore prej 1.5, 1.3, dhe 0.2 përqind respektivisht. Në raport me tremujorin paraprak, IÇIMP shënoi rënie prej 1.1 përqind si rezultat i rënies/stagnimit në të gjitha kategoritë brenda këtij indeksi.

Indeksi i çmimeve të prodhimit (IÇP) rezultoi me rritje prej 0.9 përqind në TM2 2024 kundrejt TM2 2023. Kjo rritje u përcaktua kryesisht nga rritja e çmimeve të përpunimit të produkteve ushqimore prej 5.3 përqind, prodhimit të pijeve prej 3.6 përqind, prodhimit të metaleve prej 5.1 përqind, etj. Sidoqoftë, kategoritë tjera me peshë të madhe në indeks si prodhimi i energjisë elektrike, mineraleve jometalike, dhe mobileve vijuan të rezultojnë më të ulëta kundrejt periudhës së njëjtë të vitit paraprak. Megjithatë, kundrejt tremujorit

paraprak, u evidentua rritje e çmimeve të prodhimit në kategoritë me peshën më të madhe në këtë indeks, duke bërë që indeksi i çmimeve të prodhimit të shënojë rritje prej 1.7 përqind në terma tremujorë.

Indeksi i Kostos së Ndërtimit (IKN) në TM2 2024 shënoi rritje vjetore prej 3.9 përqind diktuar kryesisht nga rritja e pagave në sektorin e ndërtimit prej 16.8 përqind, rritja e çmimeve të materialeve ndërtimore (2.0 përqind), dhe transportit (6.3 përqind). Ndërsa, u evidentua rënie në çmimet e makinerive dhe energjisë. Në raport me TM1 2024, IKN rezultoi me rritje prej 3.2 përqind, si pasojë e rritjes së çmimeve në të gjitha kategoritë, posaçërisht pagave që u rritën me 8.4 përqind, dhe rritjes së çmimeve të makinerive dhe energjisë, pas rënies së shënuar në tremujorin paraprak.


Sa i përket perspektivës së inflacionit në Kosovë, BQK parashikon që inflacioni në vitin 2025 të arrijë mesatare vjetore prej 1.8 përqind. Ky trend pritet të mbështetet, ndër të tjera, nga pritjet për stabilizim të çmimeve të mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare, rënia e inflacionit në eurozonë, kushtet e shtrënguara të financimit dhe ndikimit rezultues në aktivitetin ekonomik, etj. Rreziqet e ndërlidhura me projeksionet e inflacionit vijnë nga kahu i lartë dhe përbëhen kryesisht nga rreziqet për goditje në ofertë. Këto përfshijnë tensionet gjeopolitike, barrierat tregtare dhe kushtet klimatike në nivel global, ndërsa rreziqet nga ekonomia e brendshme ndërlidhen kryesisht me dinamikat e tregut të punës dhe pagave.

3.3 Sektori Fiskal

Në TM2 2024, të hyrat primare buxhetore¹ arritën vlerën neto prej 735.9 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 7.8 përqind. Kjo rritje ishte rezultat i dinamikave pozitive të aktivitetit ekonomik, përmirësimit të procesit të mbledhjes së të hyrave dhe aktiviteteve për luftimin e evazionit tatimor. Në të njëjtën periudhë, shpenzimet primare buxhetore² u rritën për 4.8 përqind, duke arritur në 649.1 milionë euro. Si rezultat i rritjes më të lartë të të hyrave buxhetore, Buxheti i Kosovës regjistroi bilanc pozitiv prej 86.8 milionë euro.

Të hyrat tatimore në TM2 2024 arritën në 649.0 milionë euro, duke shënuar rritje prej 4.5 përqind krahasuar me TM2 2023. Gjatë kësaj periudhe, shumica e kategorive tatimore shënuan rritje, me rritjen më e lartë të evidentuar në të hyrat tatimore indirekte, të cilat përbënin rreth 70.8 përqind të gjithë të hyrave buxhetore. Të hyrat nga tatimet indirekte shënuan rritje prej 6.8 përqind, duke arritur vlerën 521.1 milionë euro. Në kuadër të tatimeve indirekte, të hyrat nga TVSH-ja dhe detyrimi doganor shënuan rritje prej 10.7 përkatësisht 13.2 përqind, ndërsa tatimi i akcizës shënoi rënie prej 4.2 përqind, kryesisht si rezultat i rënies së sasisë së importit të duhanit (grafiku 9). Të hyrat nga tatimet direkte shënuan rritje prej vetëm 0.6 përqind, duke arritur vlerën prej 145.1 milionë euro. Kjo rritje e ngadalësuar u ndikua nga rënia e të hyrave nga tatimi në pronë për 45.0 përqind, duke arritur nivelin prej 11.1 milionë euro. Megjithatë, tatimi në të ardhurat personale, si kategoria kryesore, shënoi rritje vjetore prej 14.2 përqind, ndërsa tatimi në të ardhurat e korporatave shënoi rritje vjetore prej 4.6 përqind. **Të hyrat jo-tatimore shënuan rritje edhe më të lartë prej**

Grafik 9. Struktura e të hyrave tatimore



Burimi: MFPT dhe kalkulimet e BQK-së.

¹ Në kuadër të të hyrave buxhetore nuk janë përfshirë të hyrat nga interesi, pranimet nga financimi dhe pranimet nga grantet e përcaktuara të donatorëve.

² Në kuadër të shpenzimeve buxhetore nuk janë përfshirë pagesat për financim dhe pagesat nga grantet e përcaktuara të donatorëve.

42.1 përqind, duke arritur në 87.0 milionë euro. Në këtë kategori, të hyrat nga qeveria qendrore arritën vlerën prej 58.1 milionë euro, me një rritje prej 62.7 përqind, ndërsa të hyrat nga qeveria lokale shënuan rritje prej 6.1 përqind, duke arritur në 16.0 milionë euro.

Sa i përket shpenzimeve buxhetore, shpenzimet rrjedhëse shënuan rritje prej 4.8 përqind. Brenda kësaj kategorie, shpenzimet për paga u rritën me 18.8 përqind, duke arritur vlerën 226.9 milionë euro, ndërsa shpenzimet për mallra dhe shërbime, duke përfshirë shpenzimet komunale, shënuan rritje prej 7.7 përqind dhe arritën vlerën 103.6 milionë euro. Në anën tjetër, shpenzimet për subvencione dhe transfere pësuan rënie prej 5.7 përqind, duke arritur vlerën 209.4 milionë euro. **Po ashtu, shpenzimet kapitale shënuan rënie prej 0.9 përqind, duke arritur vlerën 109.2 milionë euro.**

Raporti i borxhit publik ndaj BPV-së u ul në 15.8 përqind në TM2 2024, krahasuar me 17.3 përqind në TM2 2023. Kjo ulje ishte rezultat i përmirësimit të bilancit buxhetor të qeverisë, duke reduktuar kështu nevojën për borxh. Në terma absolut, borxhi publik ishte 1.66 miliardë euro në TM2 2024, duke shënuar rënie prej 0.7 përqind krahasuar me TM2 2023. Zvogëlimi i borxhit publik u ndikua nga ulja e borxhit të brendshëm publik për 5.3 përqind, duke arritur në 956.3 milionë euro, ndërsa borxhi i jashtëm publik shënoi rritje prej 6.4 përqind, duke arritur në 706.3 milionë euro.


Borxhi i jashtëm publik përfshin detyrimet ndaj Agjencisë Ndërkombëtare për Zhvillim (37 përqind), Bashkimit Evropian (14 përqind), Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (12 përqind), Fondit Monetar Ndërkombëtar (10 përqind), etj. Në anën tjetër, borxhi i brendshëm përfshin kryesisht borxhin e Qeverisë së Kosovës (letrat me vlerë) ndaj fondeve pensionale (48 përqind), bankave komerciale (22 përqind) dhe institucioneve publike (21 përqind).

3.4. Sektori i jashtëm

Bilanci negativ i llogarisë rrjedhëse në TM2 2024 u thellua për 372.3 milionë euro (15.4 përqind e BPV-së), duke shënuar rritje prej 16.3 përqind krahasuar me TM2 2023 (grafiku 10). Ky zhvillim u ndikua kryesisht nga përkeqësimi i bilancit tregtar të mallrave dhe rënia e të ardhurave parësore, të cilat shtuan presionin negativ mbi bilancin e llogarisë rrjedhëse. Në anën tjetër, të ardhurat dytësore, përfshirë remitencat, si dhe shërbimet e udhëtimit dhe shërbimet e tjera të eksportuara, ndihmuan në zvogëlimin e deficitit.

Në TM2 2024, deficitin tregtar të mallrave u rrit me 6.1 përqind krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, duke arritur vlerën 1.3 miliardë euro (grafiku 11). Kjo rritje e deficitit reflekton kryesisht zgjerimin e importit të mallrave, i cili arriti vlerën prej 1.5 miliardë euro, e nxitur nga rritja e sasisë së mallrave të importuara, veçanërisht produkteve minerale, makinerive dhe mjeteve të transportit. Në anën tjetër, eksporti arriti vlerën prej 232.3 milionë euro, por mbeti në nivele relativisht të ulët, duke mbuluar vetëm 15.2 përqind të importeve apo 1:6.6 raporti tregtar.

Grafiku 10. Llogaria rrjedhëse, në milionë euro




Burimi: BQK.


Eksporti i mallrave në TM2 2024 shënoi rritje prej 10.3 përqind, duke arritur në 232.3 milionë euro, një përmirësim i dukshëm krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar (grafiku 11). Kjo rritje u mbështet kryesisht nga performanca pozitive në disa sektorë, me eksportin e metaleve bazë që shënoi rritje prej 27.3 përqind, duke arritur në 58.3 milionë euro, e ndikuar nga rritja e kërkesës për metale në tregjet ndërkombëtare, veçanërisht në vendet e rajonit dhe të BE-së. Po ashtu, eksportet e produkteve të plastikës dhe gomës shënuan rritje prej 7.5 përqind, ndërkohë që eksportet e ushqimeve të papërpunuara, pijeve dhe duhanit shënuan rritje prej 23.7 përqind, duke reflektuar zgjerim të kërkesës në tregun e jashtëm. Megjithatë, në TM2 2024, është vërejtur rënie e dukshme prej 16.7 përqind në kategorinë e produkteve tjera, kryesisht për shkak të rënies së eksporteve të dyshekëve në tregun e SHBA-së, dinamike që pritet të ndikojë në trendin e ardhshëm të eksporteve. Nga këndvështrimi gjeografik, vendet e Ballkanit Perëndimor mbeten partnerët kryesor të eksportit, duke përfaqësuar 45.3 përqind të gjithsej eksporteve, ndërsa vendet e BE-së mbulojnë 33.7 përqind, me Gjermaninë si mbetet partneri kryesor me 11.1 përqind të gjithsej eksporteve.

Vlera e gjithsej mallrave të importuara në TM2 2024 arriti në 1.5 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 6.7 përqind (63.1 përqind e BPV-së). Kjo rritje u ndikua kryesisht nga rritja e kërkesës, e cila u reflektua në rritje prej 8.0 përqind në sasinë e mallrave dhe 5.4 përqind në peshën e përgjithshme të tyre. Importi i mallrave vazhdon të dominohet nga produktet minerale, makineritë dhe pajisjet shtëpiake, mjetet e transportit dhe artikujt ushqimorë (grafiku 13). Pjesëmarrja sipas kategorive kryesore të importit u dominua nga mallrat e ndërmjetme, me 44.4 përqind të gjithsej mallrave të importuara, mallrat konsumuese me 31.3 përqind dhe mallrat kapitale që përbëjnë vetëm 11.5 përqind të importit të përgjithshëm. Sa i përket partnerëve tregtarë, Bashkimi Evropian përfaqëson rreth 46.5 përqind (711.9 milionë euro) të importeve, ku Gjermania mban peshën kryesore me 14.0 përqind të importit të përgjithshëm. Nga Turqia, u importuan mallra në vlerë prej 201.6 milionë euro (13.2 përqind e importit gjithsej). Importi i mallrave nga vendet e rajonit përbën 12.9 përqind të gjithsej importit, duke shënuar rënie krahasuar 17.3 përqind në TM2 2023. Kjo tkurrje u ndikua kryesisht nga ulja e importeve nga Serbia, pas


Grafik 11. Bilanci tregtar i mallrave



Garfik 12. Kategoritë kryesore të eksportit të mallrave, në milionë euro



Garfik 13. Kategoritë kryesore të importit të mallrave, në milionë euro




... nga ulja e importeve nga Serbia, pas

masave ndaluese të ndërmarra nga Qeveria e Kosovës ndaj mallrave serbe, duke riorientuar tregtinë kryesisht drejt vendeve të BE-së.

Bilanci i shërbimeve në TM2 2024 arriti vlerën prej 264.2 milionë euro, duke shënuar rritje të ngadalësuar prej 0.8 përqind (11.9 përqind rritje vjetore në TM2 2023). Eksporti i shërbimeve i'u atribua kryesisht rritjes së shërbimeve në kategorinë e udhëtimit, që arriti vlerën prej 380.7 milionë euro (15.7 përqind e BPV-së), e ndikuar kryesisht nga rritja e numrit të udhëtareve. Rritja e eksportit të shërbimeve u ndikua edhe nga kategoria e shërbimeve kompjuterike, me rritje prej 5.4 përqind, duke arritur vlerën prej 79.3 milionë euro. Po ashtu, eksporti i shërbimeve u zgjerua edhe në shërbimet tjera të biznesit, që shënuan rritje prej 44.1 përqind, duke arritur vlerën prej 62.8 milionë euro (43.6 milionë euro në TM2 2023). Në anën tjetër, importi i shërbimeve shënoi rritje prej 17.7 përqind, e ndikuar kryesisht nga rritja e importit të shërbimeve të udhëtimit, që u rritën 19.1 përqind krahasuar me vitin e kaluar, duke arritur vlerën prej 158.6 milionë euro, e që përbëjnë 44.5 përqind të gjithë importit të shërbimeve (grafiku 14). Rritja e vazhdueshme e importit të shërbimeve, veçanërisht në sektorin e udhëtimit, e nxitur nga lëvizja e lirë me vendet e BE-së që nga fillimi i vitit 2024, pritet të ndikojë drejtpërdrejt në tkurrjen e bilancit pozitiv të shërbimeve. Gjatë periudhës janar-korrik 2024, bilanci i shërbimeve u rrit me vetëm 3.8 përqind, një ngadalësim i dukshëm krahasuar me rritjen mesatare prej 32.8 përqind gjatë periudhës janar-korrik të viteve 2019-2023. Në këtë kontekst, rritja e importit të shërbimeve mund të ndikoi në thellimin e deficitit të llogarisë rrjedhëse.

Bilanci i të ardhurave parësore ka arritur në 39.8 milionë euro në TM2 2024 (43.6 milionë euro në TM2 2023) (grafiku 15). Kompensimi i punëtorëve arriti vlerën prej 101.6 milionë euro, duke shënuar rritje prej 25.3 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Ndërsa, të ardhurat nga investimet shënuan bilanc negativ prej 61.1 milionë euro (37.9 milionë euro në TM2 2023), si pasojë e kthimit të dividendës nga investimet e huaja direkte.


Grafik 14. Bilanci i shërbimeve



Burimi: BQK.

Burimi: BQK.

Grafik 15. Bilanci i të ardhurave parësore




Burimi: BQK.

Vlera e remitencave të pranuar në TM2 2024 arriti në 349.0 milionë euro, që përbën 14.4 përqind të BPV-së, duke shënuar rënie prej 2.0 përqind krahasuar me TM2 2023 (grafiku 16). Gjermania dhe Zvicra vazhdojnë të jenë burimet kryesore të remitencave, të cilat përbëjnë 56.6 përqind të gjithsej remitencave, e ndjekur nga SHBA-të dhe vendet tjera të BE-së. Remitencat përmes kanaleve formale, si bankat dhe institucionet e tjera financiare, shënuan rritje prej 1.9 përqind, ndërsa remitencat përmes kanaleve joformale shënuan rënie prej 12.1 përqind. Ngadalësimi i rritjes së remitencave prej vetëm 0.3 përqind në TM2 2024 kundrejt periudhës së njëjtë të vitit të kaluar, mund të jetë ndikuar nga liberalizimi i vizave me vendet e BE-së. Ky proces ka ndikuar në rritjen e vizitave të kosovarëve në diasporë, ku shumica e mërgimtarëve ndihmojnë financiarisht familjet e tyre për të mbuluar shpenzimet e udhëtimit. Rritja më e ngadalësuar e remitencave, në kombinim me rritjen e importit të shërbimeve të udhëtimit, mund të ndikojë negativisht në rritjen ekonomike dhe fuqinë blerëse të popullsisë.


IHD-të në TM2 2024 rezultojnë të kenë shënuar rritje vjetore prej 8.6 përqind, duke arritur vlerën prej 204.0 milionë euro, që përbënë 8.4 përqind të BPV-së (grafiku 17). Rritja e IHD-ve është evidentuar kryesisht në sektorin e patundshmërisë, me rritje prej 19.3 përqind, duke arritur vlerën prej 136.6 milionë euro (114.5 milionë euro në TM2 2023). Në TM2 2024 është shënuar gjithashtu rritje e IHD-ve në aktivitetet financiare (përfshirë sigurimet), furnizimi me energji elektrike dhe ndërtimtari (grafiku 18). Investimet direkte të rezidentëve nga Kosova në vendet tjera shënuan rritje prej 33.4 përqind në TM2 2024, duke arritur vlerën prej 70.0 milionë euro (52.5 milionë euro në TM2 2023). Këto investime janë përqendruar kryesisht në sektorin e patundshmërisë dhe janë drejtuar kryesisht në vendet e rajonit.

Grafik 16. Remitencat




Burimi: BQK.

Grafik 17. Investimet e huaja direkte



Burimi: BQK.

Grafik 18. Investimet e huaja direkte sipas aktiveve kryesore



Burimi: BQK.

4. Sistemi financiar


Sistemi financiar në vend ka vazhduar të zgjerohet me ritëm të shpejtë të rritjes dyshifrore në gjysmën e parë të vitit 2024, megjithëse më të ulët se në vitin paraprak. Asetet e sistemit financiar arritën vlerën prej 11.47 miliardë euro në qershor 2024, që përfaqëson rritje vjetore prej 12.4 përqind (grafiku 19). Sektori pensional dhe ai mikrofinanciar shënuan përshejtim të rritjes, ndërsa sektori bankar dhe ai i sigurimeve shënuan ngadalësim në normën e rritjes vjetore të aseteve.

Në qershor 2024, sektori bankar përfaqëson 66.3 përqind të aseteve të përgjithshme të sistemit financiar dhe, për shkak të peshës së tij të lartë në sistem, dha kontributin kryesor në zgjerimin e tij, pavarësisht rritjes vjetore më të ngadalësuar (grafiku 20). Fondet pensionale shënuan rritje vjetore më të lartë krahasuar me vitin e kaluar, duke rritur pjesëmarrjen në asetet e përgjithshme të sistemit financiar në 25.6 përqind. Ndërkohë, ndihmësit financiar shënuan rënie vjetor, por për shkak të peshës së ulët prej vetëm 0.1 përqind të aseteve të sistemit financiar, kishin kontribut marginal negativ në rritje.

4.1. Sektori bankar


Asetet e sektorit bankar arritën vlerën prej 7.60 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 10.3 përqind, për 4.3 pikë përqindje më ulët se periudha e njëjtë e vitit paraprak (grafiku 21). Rritja vjetore më e ngadalshme e burimeve të financimit të bankave, ndër tjera, u reflektua në dinamikën e zërave kryesorë të bilancit të bankave, kreditimin dhe investimet në letrat me vlerë, të cilat megjithë rritjen e lartë, shënuan normë lehtësisht më të ulët të rritjes krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Në kuadër të zërave tjerë të bilancit të sektorit, me rënie vjetore u karakterizua bilanci me bankat komerciale, potencialisht ndikuar nga rënia e normave të interesit në nivel global.

Grafik 19. Vlera e aseteve të sistemit financiar të Kosovës




Burimi: BQK.

Grafik 20. Kontributi në rritje i aseteve të sistemit financiar, në pikë përqindje



Burimi: BQK.

Grafik 21. Bilanci i gjendjes të sektorit bankar - asetet




Burimi: BQK.

Kreditimi shënoi rritje vjetore prej 13.4 përqind, për 1.1 pikë përqindje më ulët se gjysma e parë e vitit paraprak. Ky zhvillim reflekton rritjen më të ngadalshme të kreditimit për korporatat jofinanciare, ndërsa kreditë për ekonomitë familjare përsheptuan ritmin e rritjes vjetore, duke dhënë kontributin kryesorë në rritjen e gjithsej kreditimit (grafiku 22 dhe 23). Sipas Anketës së Kreditimit Bankar të Kosovës (AKBK), kërkesa kreditore ndikoi dinamikën e kreditimit në tremujorin e dytë të vitit 2024, pasi oferta kreditore pësoi ndryshime minimale kryesisht përmes ofrimit të normave lehtësisht më të ulëta të interesitë ndikuar gjithashtu nga dinamikat globale në norma të interesit. Ky zhvillim ishte më i shprehur për ekonomitë familjare, ndërsa për korporatat jofinanciare standardet mbetën kryesisht të pandryshuara. Megjithatë struktura e përgjithshme e kreditimit vazhdon të dominohet prej segmentit të korporatave jofinanciare, segmenti i ekonomive familjare është duke zgjeruar relativisht më shpejtë pjesëmarrjen e saj në gjithsej kreditimin e sektorit. Kjo rritje po drejtohet kryesisht nga zgjerimi i kredive të ekonomive familjare me afate më të gjata maturimi, përderisa kreditë e korporatave jofinanciare nuk pësuan ndonjë ndryshim në stukturën e maturimit nga viti i kaluar. Krahas rritjes së përgjithshme të kreditimit, është rritur edhe përfshirja financiare, përkatësisht numri i kredimarrësve të rinj. Në gjysmën e parë të vitit, numri i kredimarrësve të rinj ishte për 4.8 përqind më lart se në gjysmën e parë të vitit 2023 (3.5 përqind rritja vjetore e kredimarrësve të rinjë në gjysmën e parë të vitit 2023).


Rritja më e lartë e kreditimit për ekonomitë familjare reflekton hapësirën relativisht më të madhe për zgjerim në këtë segment, duke pasur parasysh shkallën ende më të ulët të ndërmjetësimit financiar krahasuar me rajonin³, si dhe shkallën e lartë të ekonomive familjare që nuk

Grafik 22. Stoku i gjithsej kredive, ndryshimi vjetor




Burimi: BQK.

Grafik 23. Kontributi në rritjen e gjithsej kredive, në pikë përqindje



Burimi: BQK.

Grafik 24. Kontributi në rritjen e gjithsej kreditimit për korporatat jofinanciare, sipas aktivitetit ekonomik




Burimi: BQK.

³ Hendeku i kreditimit të sektorit të ekonomive familjare ndaj BPV-së në krahasim me rajonin në qershor 2024 ishte -0.5 pikë përqindje, që nënkupton se në Kosovë, niveli i kredive për ekonomi familjare ndaj BPV-së është më i ulët se në vendet e rajonit për 0.5 pp. Treguesi i njëjtë për kreditë ndaj ndërmarrjeve qëndroi në 10.6 pikë përqindje mbi mesataren e rajonit.

posedojnë fare kredi⁴, përderisa performanca e ripagimit të kredive të këtij segmente historikisht ishte e kënaqshme. Gjithashtu, rritja e të hyrave ose pritjet për një rritje të t'ardhurave nga sektori publik mund të kenë ndikuar pozitivisht në rritjen e gatishmërisë së ekonomive familjare për të marrë hua, duke pasqyruar pritje më optimiste për të ardhmen apo preferencë për investime si metodë për ruajtje të vlerës së parasë. Për më tepër, çmimet e rritura të produkteve dhe shërbimeve në vitet pas pandemisë kanë ndikuar që vlera e kredive të kërkuara nga bankat, për qëllime konsumi dhe renovimi të rritet, gjë që mbështetet edhe nga rritja e vlerës mesatare të kredisë.

Segmenti i korporatave jofinanciare shënoi rritje vjetore të stokut të kredive prej 9.5 përqind, për 3.4 pikë përqindje më ulët se në gjysmën e parë të vitit paraprak. Sektori i prodhimit u karakterizua me ngadalësimin më të theksuar të normës së rritjes, përkatësisht rritje vjetore prej 1.5 përqind nga 15.1 përqind në gjysmën e parë të vitit paraprak. Kreditimi për sektorin e tregtisë shënoi rritje vjetore lehtësisht më të ulët krahasuar me vitin paraprak, por vazhdon të mbetet me kontributin më të madh në rritjen e stokut të gjithsej kredive (grafiku 24). Kreditimi ndaj sektorit të bujqësisë shënoi rritje të konsiderueshme vjetore, ndikuar edhe nga mbështetja e Fondit të Kosovës për Garanci Kreditorë (FKGK) (grafiku 25). **Ngadalësimi i kreditimit në sektorët kyç ekonomik gjatë kësaj periudhe është në linjë me kontributin e këtyre segmentëve në BPV, e cila në mesatare në gjysmën e parë të vitit 2024 ka shënuar ngadalësim në industrinë përpunuese, ndërtimatri dhe tregti krahasuar me një vit më parë. Kurse, kontributi i sektorit të bujqësisë në BPV një gjysmën e parë të vitit 2024 ishte pozitiv kundrejt impaktit negativ një vit më parë. Kredia e re e dhënë për segmentin e korporatave jofinanciare shënoi rënie vjetore për 1.8 përqind në krahasim me rritjen prej 11.1 përqind në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.** Në këtë rënie ndikuan të dy kategoritë e kredive të reja për korporata jo-financiare, ato me karakter investues që shënuan rritje me ritëm të ngadalësuar prej 4.6 përqind krahasuar me rritjen prej 13.6 përqind një vit më parë, si dhe kreditë me karakter jo-investues që pësuan rënie prej 13.9 përqind, krahasuar me rritjen prej 11.6 përqind në vitin e kaluar. Normat e interesit të aplikuara nga bankat për segmentin e korporatave jofinanciare në përgjithësi nuk kishin ndryshime të theksuara gjatë kësaj periudhe, me rënie marginale të evidentuar në disa muaj.

Grafik 25. Ndryshimi vjetor në kreditë ndaj korporatave jofinanciare, sipas veprimtarisë ekonomike



Burimi: BQK.

Kreditë për ekonomitë familjare përshpejtuan rritjen vjetore në 19.4 përqind, nga 16.8 përqind në vitin e kaluar, zhvillim i reflektuar nga rritja e përshpejtuar e kredive të reja për këtë segment prej 36.4 përqind, nga 6.1 përqind rritje në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (grafiku 26) Kjo rritje është ndikuar kryesisht nga dinamika e kredive konsumuese, të cilat shënuan rritje të lartë vjetore prej 44.2 përqind nga 10.6 përqind në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Po ashtu, kreditë hipotekare rikuperuan trendin rritës të viteve të mëparshme, duke u rritur për 16.8 përqind, pas një rënieje prej 9.6 përqind në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Rezultatet e Anketës së Kreditimit Bankar të Kosovës për TM2 2024 sugjerojnë se rritja erdhi nga kërkesa më e lartë nga ekonomitë familjare për financimin e nevojave për konsum dhe blerje të shtëpive, dhe një ofertë më e lehtësuar

⁴ Në anketim të ekonomive familjare, të porositur nga BQK dhe të realizuar nga Ubo Consulting, në vitin 2021, ka rezultuar se shkalla e ekonomive familjare që nuk posedojnë fare kredi të jetë 60.3 përqind.


për këtë segment krahasuar me atë për bizneset. Në kuadër të kredive të reja konsumuese, rritja më e theksuar është koncentruar në kredite me vlera më të larta, përkatësisht në vlerë mbi 10 mijë euro dhe të cilat kanë maturitet më afatgjatë.

Në linjë me këtë, siç u theksua më herët, rritja e kreditimit të ekonomive familjare është shoqëruar me një ndryshim gradual në strukturën e maturimit të kredive, kryesisht drejt kredive më afatgjata.

Konkretisht, kategoria ‘mbi 10 vite’ ka zgjeruar pjesëmarrjen në 35.5 përqind, për 2.0 pikë përqindje më e lartë se një vit më parë, dhe krahasuar me pesë vite më parë është rritur për 20.7 pikë përqindje. Gjithsesi, kategoria dominuese vazhdoi të jetë ajo e maturitetit ‘5 deri në 10 vite’, me pjesëmarrje prej 43.6 përqind.


Sipas të dhënave nga Regjistri i Kredive të Kosovës (RKK), kredite e reja të ekonomive familjare ⁵ të disbursuara gjatë periudhës janar-qershor 2024, në mesatare ishin në vlerë prej 10.1 mijë euro dhe afat mesatar të maturimit prej 4.9 vitesh. Më konkretisht, në aspekt të numrit të kredive të reja të lëshuara në këtë periudhë, 23.6 përqind e tyre ishin në vlerë nën 500 euro, të cilat përfaqësojnë kryesisht borxhin e shfrytëzuar në kredit-kartela, por të cilat në aspekt të gjithsej vlerës kishin pjesëmarrje prej vetëm 0.95 përqind. Kredite në intervalin e shumës prej 10-30 mijë euro përbënin 18.8 përqind të gjithsej numrit të kredive të disbursuara, ndërsa në aspekt të vlerës kishin pjesëmarrje prej 36.0 përqind, duke rezultuar në kategorinë dominuese në aspekt të vlerës së gjithsej kredive të reja për ekonomitë familjare. Kredite në intervalin 30-60 mijë euro kishin pjesëmarrje prej 5.6 përqind në numër, ndërsa 22.4 përqind në vlerë të gjithsej kredive. Kredite me vlerë të barabartë apo mbi 60 mijë euro, të cilat kryesisht përfshijnë kredite hipotekare dhe lizingjet, kishin pjesëmarrje të ulët në numër, prej 1.8 përqind por në vlerë kishin pjesëmarrje prej 20.8 përqind të gjithsej vlerës së kredive të reja. Në aspekt të maturitetit, numri i kredive me maturitet 3-5 vite kishin pjesëmarrjeje dominuese prej 42.6 përqind. Ndërsa, në bazë të vlerës së kredive të disbursuara, kredite në maturitetin 5-10 vite kanë pjesëmarrje dominuese prej 38.2 përqind.

Grafik 26. Kredite e reja, ndryshimi vjetor



Burimi: BQK.

Grafik 27. Stoku i gjithsej depozitave



Burimi: BQK.


⁵ Duke përfshirë mbiterheqet, vlera e të cilave përbënte 2.01 përqind të gjithsej shumës së disbursuar të kredive të ekonomive familjare gjatë kësaj periudhe (gjysmës së parë të vitit 2024).

Depozitat e sektorit bankar në gjysmën e parë të vitit shënuan rritje vjetore prej 9.4 përqind, për 6.6 pikë përqindje më e ulët krahasuar me një vit më parë. Vlera totale e depozitave arriti në 6.13 miliardë euro (grafiku 27). Dy segmentet kryesore, korporatat jofinanciare dhe ekonomitë familjare, shënuan ngadalësim në trendin e rritjes vjetore të depozitave në 10.5 përqind nga 24.7 përqind dhe në 8.2 përqind nga 11.6 përqind, përkatësisht. Depozitat e korporatave publike shënuan një rritje të lartë dyshifrore, por me ritëm të ngadalësuar në krahasim me një vit më parë. Depozitat nga korporatat e tjera financiare, kryesisht të fondeve pensionale, shfaqën një rritje të ngadalësuar krahasuar me rritjen e lartë të një viti më parë, si pasojë e investimeve më të larta në tregun e jashtëm (grafiku 28). Në fund të tremujorit të dytë të vitit 2024, depozitat përbënin 80.8 përqind të gjithsej detyrimeve dhe kapitalit të sektorit, një rënie prej 0.7 pikë përqindje krahasuar me fundin e tremujorit të dytë të vitit të kaluar.


Depozitat e reja, që përfshijnë vetëm depozitat e afatizuara, vazhduan të rriten me ritëm të lartë, të nxitura nga ambienti me norma më të larta të interesit dhe kampanjave të bankave për të tërhequr depozita. Në fund të qershorit 2024, vlera e këtyre depozitave arriti në 426.5 milionë euro, krahasuar me 285.1 milionë euro një vit më parë, duke shënuar një rritje vjetore prej 49.6 përqind, nga 41.7 përqind në vitin e kaluar. Depozitat e reja për ekonomitë familjare patën rritje të lartë prej 51.0 përqind, nga 21.5 përqind një vit më parë, duke arritur në 290.2 milionë euro (krahasuar me 192.2 milionë euro në fund të TM2 2023). Po ashtu, depozitat e reja të korporatave jofinanciare u rritën ndjeshëm, duke arritur në 136.3 milionë euro nga 92.8 milionë euro një vit më parë (grafiku 29).

Trendi rënës i inflacionit, i shoqëruar me ulje të normave bazë të interesit nga Banka Qendrore Evropiane (BQE), ka ndikuar në uljen e presioneve për normat e interesit në sektorin bankar në vend si dhe ndërprerjen e trendit rritës të peshës së kredive me normë të ndryshueshme


Grafik 28. Kontributi në rritjen vjetore të gjithsej depozitave, pikë përqindje



Grafik 29. Depozitat e reja, ndryshimi vjetor




Grafik 30. Norma e interesit në kredi dhe depozita



interesi. Mekanizmi i transmisionit të rënies së normës së interesit nga BQE në tregun vendor ishte më efektiv në anën e kredive, të cilat shënuan rënie të normës së interesit në 6.1 përqind nga 6.5 përqind një vit më parë. Ndërsa, në anën e depozitave, presionet konkurruese për tërheqje të depozitave mbeten të larta dhe ndikuan në rritjen tutje të normës së interesit. Në qershor 2024, norma e interesit për depozita arriti nivelin më të lartë në njëmbëdhjetë vitet e fundit, përkatësisht në 2.9 përqind, nga 2.1 përqind në qershor 2023. Rrjedhimisht, margjina e interesit kredi-depozitë u ngushtua në 3.2 pikë përqindje nga 4.4 pikë përqindje në qershor 2023 (grafiku 30). Kreditë me normë të ndryshueshme interesi, pas kulmit të arritur në fund të tremujorit të katërt të vitit 2023, zbritën pjesëmarrjen në 30.6 përqind në qershor 2024 nga 31.8 përqind në tremujorin paraardhës (grafiku 31).


Grafik 31. Stoku i kredive sipas llojit të normave të interesit



Burimi: BQK.


Norma mesatare e interesit në kredi ndaj korporatave jofinanciare në qershor 2024 zbriti në 6.3 përqind, krahasuar me 6.8 përqind një vit më parë. Në kuadër të kategorive të kreditimit, norma më e favorshme e interesit në kredi u ofrua për sektorin e shërbimeve, me një mesatare prej 6.2 përqind (grafiku 32). Ndërsa, **norma mesatare e interesit për ekonomitë familjare zbriti në 5.8 përqind, duke shënuar një rënie vjetore prej 0.22 pikë përqindje.** Kreditë hipotekare, që konsiderohen me rrezik më të ulët për shkak të mbulesës me kolateral, kishin normat më të favorshme të interesit me një mesatare prej 5.0 përqind. Në anën tjetër, kreditë konsumuese vazhduan të kenë norma më të larta të interesit, mesatarisht 6.0 përqind në qershor 2024 (grafiku 33).

Grafik 32. Norma e interesit në kredi për korporatat jofinanciare



Burimi: BQK.

Grafik 33. Norma e interesit në kredi për ekonomitë familjare



Burimi: BQK.


Normat e interesit në depozita, pas një rënies në tremujorin e mëparshëm, shënoi rritje në tremujorin e dytë(grafiku 34). Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, normat e interesit shënuan rritje prej 0.8

pikë përqindje, duke arritur në 2.9 përqind në qershor 2024. Norma mesatare e interesit në depozita për korporatat jofinanciare u rrit për 0.8 pikë përqindje, duke arritur në 3.3 përqind. Po ashtu, për ekonomitë familjare norma e interesit u rrit për 0.8 pikë përqindje, duke arritur në 2.7 përqind në qershor 2024 (grafiku 34).

Sektori bankar përmbylli gjysmën e parë të vitit 2024 me profit neto prej 90.9 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore të ngadalësuar prej 10.1 përqind nga 22.3 përqind një vit më parë. Ky zhvillim reflekton rritjen më të lartë vjetore të shpenzimeve, ngase të hyrat shënuan normë lehtësisht më të ulët të rritjes në raport me vitin paraprak. Gjithsej të hyrat në gjysmën e parë të vitit arritën në 239.3 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 18.2 përqind krahasuar me rritjen prej 19.9 përqind një vit më parë. Të hyrat nga interesi përfaqësojnë 76.9 përqind të gjithsej të hyrave dhe kontribuuan kryesisht në këtë rritje, të nxitura nga rritja e kreditimit dhe normat më të larta të interesit në dy vitet e fundit. Gjithashtu, të hyrat nga letrat me vlerë patën rritje si rezultat i investimeve më të larta në këtë kategori dhe kthimeve më të larta. Të hyrat nga jo-interesi, kryesisht nga tarifat dhe komisionet, shënuan rritje prej 6.2 përqind, duke arritur në 47.4 milionë euro në fund të qershorit 2024.

Shpenzimet e sektorit bankar arritën vlerën 148.4 milionë euro, rritje vjetore prej 23.7 përqind nga 18.3 përqind rritje një vit më parë. Rritja më e lartë ishte në shpenzimet e përgjithshme dhe administrative, si dhe në shpenzimet e interesit. Kategoria me peshën më të lartë, shpenzimet e përgjithshme dhe administrative, përfaqëson 58.2 përqind të gjithsej shpenzimeve dhe u rrit për 21.4 përqind nga 15.5 përqind një vit më parë, duke arritur në 86.3 milionë euro në qershor 2024. Shpenzimet e interesit, për të dytin vit me radhë, shënuan rritje të konsiderueshme prej 47.5 përqind, krahasuar me 51.7 përqind një vit më parë, si rezultat i rritjes së normave të interesit në të gjitha kategoritë që krijojnë shpenzime të interesit, si dhe rritjes së stokut të depozitave të afatizuara (19.4 përqind përkatësisht 41.8 përqind). Rritja më e ulët e fitimit të sektorit në raport me rritjen më të lartë të kapitalit ndikoi që treguesi i Kthimit në Kapital të zbret lehtësisht në 19.1 përqind nga 21.5 përqind një vit më parë. Ndërsa kthimi në asete zbriti në 2.5 përqind


Grafik 34. Normat e interesit për depozita



Burimi: BQK.


ngase të hyrat shënuan normë lehtësisht më të ulët të rritjes në raport me vitin paraprak. Gjithsej të hyrat në gjysmën e parë të vitit arritën në 239.3 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 18.2 përqind krahasuar me rritjen prej 19.9 përqind një vit më parë. Të hyrat nga interesi përfaqësojnë 76.9 përqind të gjithsej të hyrave dhe kontribuuan kryesisht në këtë rritje, të nxitura nga rritja e kreditimit dhe normat më të larta të interesit në dy vitet e fundit. Gjithashtu, të hyrat nga letrat me vlerë patën rritje si rezultat i investimeve më të larta në këtë kategori dhe kthimeve më të larta. Të hyrat nga jo-interesi, kryesisht nga tarifat dhe komisionet, shënuan rritje prej 6.2 përqind, duke arritur në 47.4 milionë euro në fund të qershorit 2024.

Grafik 35. Profiti dhe treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar



Burimi: BQK.

Grafik 36. Kreditë joperformuese dhe mbulueshmeria me provizione



Burimi: BQK.


nga 2.6 përqind, për shkak të rritjes më të ngadalësuar vjetore të fitimit në krahasim me rritjen më të lartë të aseteve gjatë kësaj periudhe (grafiku 35).

Kreditë jo-performuese të sektorit bankar janë rritur për 21.2 përqind krahasuar me rritjen prej 8.3 përqind një vit më parë; megjithatë, raporti i kredive jo-performuese qëndron në nivel të ulët prej 2.1 përqind. Mbulueshmëria me provizione nga humbjet e mundshme nga kreditë u zvogëluua në 125.6 përqind nga 137.8 përqind në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, për shkak të rritjes më të lartë të vlerës së kredive jo-performuese në raport me rritjen e provizioneve të ndara për mbulimin e tyre (grafiku 36).

Segmenti i ekonomive familjare shënoi rritje të normës së kredive jo-performuese në 1.7 përqind nga

1.3 përqind një vit më parë, ndërsa korporatat jo-financiare mbajtën një normë të ngjashme të kredive jo-performuese prej 2.5 përqind. Ekonomitë familjare u karakterizuan me rritje më të theksuar të ekspozimeve jo-performuese, me një vlerë prej 12.8 milionë euro ose 55.8 përqind rritje vjetore, krahasuar me rritjen e kreditimit për këtë segment prej 19.4 përqind. Për segmentin e korporatave jo-financiare, ekspozimet jo-performuese u rritën për 7.2 milionë euro, apo 10.0 përqind, ndërsa gjithsej kreditë për korporatat jo-financiare u rritën për 9.5 përqind. Sektori i prodhimtarisë dhe bujqësisë shënoi rritje të vlerës së KJP-ve për 8.2 dhe 1.1 milionë euro, respektivisht, me rritje në raport me kreditë për 1.2 dhe 1.9 pikë përqindje, duke arritur në norma të KJP-ve prej 3.0 përqind për prodhimtari dhe 7.1 përqind për bujqësi. Në anën tjetër, sektorët si tregtia dhe shërbimet shënuan rënie të vlerës së KJP-ve prej 1.28 dhe 1.27 milionë euro, duke rezultuar në norma të kredive jo-performuese prej 1.6 përqind për tregtinë dhe 3.3 përqind për shërbimet.


Grafik 37. Treguesi i solvencës



Burimi: BQK.

Pozicioni i kapitalit, i shprehur përmes normës së kapitalit rregullativ ndaj mjeteve të peshuara me rrezik, është rritur në 16.1 përqind nga 15.3 përqind në qershor 2023. Rritja vjetore e kapitalit rregullativ për 0.8 pikë përqindje krahasuar me fundin e tremujorit të dytë të vitit 2023 u ndikua nga rritja më e lartë e kapitalit rregullativ në raport me rritjen e mjeteve të peshuara me rrezik, të cilat shënuan ngadalësimin më të theksuar të shkallës së rritjes. Kapitali rregullativ në fund të tremujorit të dytë shënoi një rritje vjetore prej 16.2 përqind nga 17.8 përqind rritje një vit më parë, si rezultat i ngadalësimit të rritjes së fitimit deri në qershor 2024. Njëkohësisht, mjetet e peshuara me rrezik shënuan ngadalësim të rritjes në 10.2 përqind nga 16.3 përqind në qershor 2023 (grafiku 37), të ndikuara nga ecuria e kreditimit.

Grafik 38. Treguesit e likuiditetit




Burimi: BQK.

Treguesi i mbulimit me likuiditet të sektorit (LCR) qëndroi mbi nivelin minimal prej 100 përqind të kërkuar me rregullore, dhe shënoi rritje të lehtë vjetore në 204.2 përqind nga 197.2 përqind një në qershor 2023. Ky nivel dëshmon se bankat mbajnë mjaftueshëm mjete likuide për të plotësuar nevojat dalëse (rrjedhjes së parasë) për një periudhë 30 ditore. Për më tepër, edhe Treguesi i Financimit të Qëndrueshëm Neto (NSFR) u rrit nga 197.2 përqind në 204.2 përqind në qershor 2024, duke sugjeruar forcim të pozicionit më afatgjatë të likuiditetit të bankave. Ndërsa, raporti i likuiditetit - i shprehur si raport i mjeteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra - shënoi rënie vjetore për 1.4 pikë përqindje, duke zbritur në 29.8 përqind. Kjo si rezultat i rritjes vjetore më të theksuar të detyrimeve afatshkurtra prej 9.6 përqind në raport me rritjen e mjeteve likuide prej 4.7 përqind (grafiku 38). Gjithashtu, rritja më e lartë e kreditimit në raport me depozitat ka ndikuar në rritjen e raportit kredi-depozitë për 3.1 pikë përqindje, duke arritur në 87.2 përqind.

4.2. Sektori pensional

Asetet e sektorit pensional shënuan rritje vjetore të përshpejtuar prej 15.8 përqind në gjysmën e parë të vitit 2024, nga 11.2 përqind rritje në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (grafiku 39). Përmirësimi deri në një masë i treguesve makroekonomik global, ndikuar kryesisht nga rënia e trendit global të inflacionit dhe pritjet për lehtësimin e politikës monetare, ndër tjera, reflektuan pozitivisht në rritjen e përshpejtuar të sektorit. Gjatë periudhës janar-qershor 2024, Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK) ka arritur të shënoj rritje në kthimin nga investimet dhe rritje të kontributeve të arkëtuara. Po ashtu, Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve (FSKP) ka shënuar rritje në kthimin nga investimet, mirëpo kontributet e arkëtuara shënuan rënie krahasuar me vitin paraprak.

Grafik 39. Asetet e sektorit pensional




Burimi: BQK.

Vlera e aseteve pensionale arriti në 2.94 miliardë euro, nga të cilat 99.7 përqind përfaqësohen nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK), dhe pjesa e mbetur prej 0.3 përqind nga Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve (FSKP). Asetet e FKPK-së shënuan rritje vjetore prej 15.8 përqind, ndërsa asetet e Fondit Slloveno-Kosovar të Pensioneve (FSKP) u rritën për 11.8 përqind nga viti i kaluar.

Asetet e FKPK-së janë të investuara kryesisht në tregun e jashtëm, me pjesëmarrje të rritur për 8.3 pikë përqindje në gjysmën e parë të vitit, duke arritur në 78.0 përqind të gjithsej portfolios investuese. Vlera e aseteve të investuara jashtë vendit arriti në 2.29 miliardë euro, të investuara kryesisht në fonde të përbashkëta. Ndërsa pjesa tjetër e investimeve, prej 643.4 milion euro janë të diversifikuara në tregun e brendshëm. Këto investime zbritën pjesëmarrjen në 22.0 përqind të gjithsej portfolios investuese, rënie për 8.3 pikë përqindje nga viti paraprak.


Grafik 40. Pjesëmarrja e investimeve të fondeve pensionale



Zërat që shënuan rënie vjetore në kuadër të investimeve në tregun e brendshëm ishin paraja e mbajtur në BQK dhe investimet në certifikata të depozitit. Paraja në BQK zbriti në 27.6 milionë euro nga 149.0 milionë euro një vit më parë, apo në 0.9 përqind të gjithsej portfolios investuese nga 5.9 përqind pjesëmarrje një vit më parë. Kategoria e certifikatave të depozitit në bankat vendore zbriti në 91.6 milionë euro nga 128.9 milionë, apo në 3.1 përqind pjesëmarrje të gjithsej investimeve, nga 5.1 përqind sa ishte një vit më parë. Ndërsa, për dallim nga kategoritë e tjera të investimeve të brendshme, kategoria e investimeve në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës u rrit në 524.3 milionë euro nga 448.4 milionë, por për shkak të rritjes së tyre të ulet në kuadër të rritjes së total aseteve, pesha e investimeve në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës në kuadër të gjithsej investimeve shënoi rënie në 17.9 përqind nga 19.3 përqind në vitin paraprak.

Kontributet e arkëtuara nga FKPK deri në fund të muajit qershor 2024 arritën në 153.0 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore më të ngadalësuar, prej 13.6 përqind nga 15.9 përqind një vit më parë (grafiku 41). Rritja më e ngadalësuar këtë vit është efekt i bazës më të lartë të kontributeve në vitin e kaluar, të ndikuar nga rritja e pagave të shërbyesve civil në fillim të vitit 2023.

Grafik 41. Performanca e FSKP-së




Kthimi bruto në investime arriti në 117.8 milionë euro, shumëfish më i lartë krahasuar me kthimin gjatë periudhës së njëjtë të një viti më parë prej 24.1 milionë euro.

Kontributin kryesor kishin kthimet në vlerë prej 108.3 milionë euro në tremujorin e parë të vitit, e ndikuar nga rritja e çmimit të aksioneve në tregjet ndërkombëtare, si rezultat i sinjaleve pozitive të politikave monetare për frenim të rritjes tutje të normave bazë të interesit. Ndërsa, kthimet në tremujorin e dytë të vitit ranë ndjeshëm në 9.6 milionë euro dhe krahasuar me tremujorin e dytë të vitit paraprak shënuan rënie për 59.5 përqind. Efektet e zgjatura të politikës së shtrënguar monetare dhe rënia e inflacionit me ritëm më të ngadalshëm sesa pritej, ndikuan në kthim më të ulët nga investimet në tregjet ndërkombëtare krahasuar me tremujorin paraprak dhe atë të një viti më parë.

FSKP po ashtu ka rritur investimet në tregun e jashtëm kundrejt zvogëlimit të investimeve në tregun e brendshëm, duke arritur në 78.7 përqind të gjithsej portfolios investuese (grafiku 40). Vlera e aseteve

të investuara jashtë vendit shënoi rritje për 0.8 pikë përqindje nga qershori i vitit të kaluar dhe arriti në 8.0 milionë euro. Investimet në tregun e jashtëm janë kryesisht të orientuara në aksione me pjesëmarrje prej 82.9 përqind të gjithsej portfolios investuese. Pjesa tjetër përbëhet nga paraja e gatshme me pjesëmarrje prej 2.2 përqind në gjithsej portfolion investuese. Ndërsa, në kuadër të investimeve brenda vendit peshën kryesore kanë investimet në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës, me pjesëmarrje prej 13.2 përqind në gjithsej portfolion investuese, duke arritur vlerën prej 1.2 milionë euro. Pjesa tjetër e mjeteve të mbajtura në vend, që përbëhet nga paraja e gatshme dhe depozitat e mbajtura në bankat komerciale, përbëjnë 1.7 përqind të portfolios.

Grafik 42. Performanca e FKPK-së




Burimi: FKPK.

Vlera e kontributeve të arkëtuara nga FSKP-ja deri në fund të qershorit 2024 zbriti në 330.2 mijë euro, që paraqet një rënie vjetore prej 2.0 përqind nga periudha e njëjtë e vitit paraprak (grafiku 42). Kurse, kthimi në investime i FSKP-së shënoi rritje të lartë, në 737.8 mijë euro nga 481.7 mijë euro fitim në periudhën e njëjtë të një viti më parë.

4.3. Sektori i sigurimeve

Asetet e sektorit të sigurimeve kanë vazhduar trendin e rritjes edhe përgjatë tremujorit të dytë të vitit 2024, por me ritëm më të ngadalësuar se në vitin paraprak për këtë periudhë raportuese. Vlera e gjithsej aseteve arriti në 330.1 milionë euro në fund të qershorit 2024, duke shënuar rritje vjetore prej 12.2 përqind nga 16.0 përqind rritje vitin e kaluar (grafiku 43). Zgjerimi i sektorit u mundësua nga rritja e primeve të shkruara përgjatë gjysmës së parë të vitit 2024, si dhe kapitalit vetanak të siguruesve. Rritjen më të theksuar në kuadër të aseteve e shënoi kategoria e depozitave të mbajtura në bankat komerciale,

Grafik 43. Asetet e sektorit të sigurimeve



Burimi: BQK.

kryesisht të afatizuara, të cilat shënuan rritje prej 14.8 përqind dhe njëherësh janë kategoria me peshën kryesore në gjithsej asetet. Rritje shënuan edhe kategoria e Letrave me Vlerë të Qeverisë së Kosovës dhe rezervat teknike të risiguruesve, të cilat u rritën për 7.6 përqind dhe 18.4 përqind, respektivisht.

Primet e shkruara bruto arritën vlerën 83.0 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore të përshpejtuar prej 18.0 përqind nga 14.5 përqind në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Sigurimet 'Jo-Jetë' shënuan rritje vjetore të primeve të shkruara bruto për 18.5 përqind, ndërsa sigurimet 'Jetë' u rritën për 9.4 përqind në krahasim me gjysmën e parë të vitit paraprak. Kategoria 'Përgjegjësi motorike ndaj palës së tretë' e cila ka peshën kryesore në kuadër të sigurimeve 'Jo-Jetë', me pjesëmarrje prej 51.9 përqind, kishte kontributin kryesor


në rritjen e sigurimeve 'Jo-Jetë'. Vlera e primeve të shkruara bruto të kësaj kategorie arriti në 40.6 milionë euro apo rritje vjetore për 11.7 përqind nga 8.7 përqind rritje në qershor të vitit të kaluar. Po ashtu, rritje të theksuar shënuan edhe kategoritë si 'Sigurimi i shëndetit', 'Sigurimi nga zjarri dhe forcat e natyrës' dhe 'Sigurimi i garancive', në kuadër të sigurimit vullnetar 'Jo-Jetë'. Vlera e primeve për kategorinë 'Sigurimi i shëndetit' shënoi rritje të përshpejtuar prej 24.5 përqind nga 20.8 përqind në vitin paraprak, duke arritur në 18.9 milionë euro. Po ashtu, kategoritë 'Sigurimi nga zjarri dhe forcat e natyrës' dhe 'Sigurimi i garancive' shënuan rritje të përshpejtuar vjetore të primeve të shkruara bruto, përkatësisht rritje prej 32.0 dhe 26.1 përqind, duke arritur në 4.7 dhe 5.4 milionë euro, respektivisht. Primet e shkruara bruto në kuadër të sigurimit 'Jetë' arritën në 3.9 milionë euro apo rritje vjetore prej 9.4 përqind nga 4.3 përqind në qershor 2023. Kontributin kryesor në këtë rritje kishte kategoria 'Jeta e debitorit', e cila shënoi rritje vjetore të përshpejtuar prej 17.1 përqind nga 3.3 përqind dhe përfaqësoi 51.7 përqind të gjithsej primeve të shkruara 'Jetë' në fund të periudhës.

Numri i policave të sigurimit vazhdoi trendin e rritjes edhe në tremujorin e dytë të vitit, duke arritur në 977.7 mijë polica të shitura apo rritje vjetore prej 46.9 përqind. Sektori i sigurimeve 'Jo-Jetë' shënoi rritje më të theksuar në numrin e policave të shitura, duke arritur në 938.5 mijë polica të shitura apo rritje prej 49.4 përqind. Ndërsa, sektori 'Jetë' shënoi rritje më të ulët prej vetëm 5.6 përqind. 'Sigurimi i shëndetit' në kuadër të sigurimit 'Jo-Jetë' shënoi rritjen më të theksuar të policave të shitura duke arritur në 390.2 mijë polica apo rritje për 125.1 përqind. Mirëpo, peshën kryesore në numrin e policave të shitura vazhdon ta ketë kategoria 'Përgjegjësi motorike ndaj palës së tretë' e cila përfaqëson 52.2 përqind të gjithsej policave të shitura dhe arriti në 489.7 mijë polica deri në fund të qershorit 2024.

Vlera e dëmeve të paguara nga kompanitë e sigurimit dhe Byroja Kosovare e Sigurimeve, shënoi rënie të lehtë, për dallim nga gjysma e dytë e vitit paraprak që u karakterizua me rritje. Vlera e tyre zbriti në 35.0 milionë euro nga 36.2 milionë euro, apo rënie për 3.4 përqind nga rritja prej 17.2 përqind në vitin paraprak (grafiku 44). Vlera e dëmeve të paguara vetëm nga kompanitë e sigurimeve shënoi rënie vjetore prej 5.4 përqind, duke zbritur në 31.4 milionë euro në fund të qershorit 2024. Ndërsa, vlera e dëmeve të paguara nga BKS-ja arriti në 3.6 milionë euro në fund të qershorit 2024, duke shënuar rritje vjetore prej 19.0 përqind. Mirëpo, për shkak të peshës së vogël prej vetëm 10.4 përqind të dëmeve të paguara nga BKS-ja në gjithsej dëmet e paguara, rritja e kësaj kategorie nuk ndikoi në rritjen e përgjithshme të dëmeve të paguara. Kontributin kryesor në rënien e dëmeve të paguara nga sektori i sigurimeve, ngjashëm me tremujorin paraprak kishte kategoria 'Sigurimi nga zjarri dhe forcat e natyrës', e cila shënoi rënie për 4.7 milionë euro duke zbritur në 568.5 mijë euro. Ndërsa, kategoria me peshën më të madhe në kuadër të dëmeve të paguara, ajo e 'Përgjegjësisë motorike ndaj palëve të treta', u rrit për 5.8 përqind, kryesisht nga policat kufitare dhe MTPL-të e brendshme.

Profiti neto i sektorit të sigurimeve në gjysmën e parë të vitit shënoi rritje vjetore të përshpejtuar, përkatësisht rritje prej 46.2 përqind dhe arriti vlerën në 8.6 milionë euro. Shkalla më e lartë e rritjes së të hyrave në raport me atë të shpenzimeve dhe dëmeve të ndodhura (por jo të paguara), ndikoi në rritjen e profitit të sektorit. Të hyrat e sektorit, që janë kryesisht nga primet e shkruara arritën në 70.9 milionë euro apo rritje për 17.2 përqind nga viti paraprak. Dëmet e ndodhura (por jo të paguara) arritën në 37.8 milionë euro apo rritje prej 14.7 përqind nga qershori i vitit të kaluar. Po ashtu, shpenzimet operationale (që përfshijnë

Grafik 44. Primet e shkruara dhe dëmet e paguara



Burimi: BQK.

shpenzimet për personelin dhe administrative) shënuan rritje vjetore prej 15.0 përqind, duke arritur në 22.1 milionë euro. Rritja e profitit neto u reflektua në ngritjen e tregueseve të profitabilitet. Kthimi në kapital arriti në 11.0 përqind nga 8.6 përqind nga viti i kaluar, ndërsa kthimi në asete arriti në 3.1 përqind nga 2.4 përqind sa ishte një vit më parë.

Treguesit e qëndrueshmërisë së sektorit shënuan rënie krahasuar me fundin e vitit 2023. Në qershor 2024, kapitali në raport me fondin garantues për siguruesit jo-jetë zbriti në 156.8 përqind nga 159.2 përqind në fund të vitit paraprak, përderisa për siguruesit jetë raporti ishte 166.6 përqind. Kapitali në raport me marginën minimale të Solvencës për siguruesit jo-jetë ishte 146.2 përqind nga 161.4 përqind në dhjetor 2023, përderisa për siguruesit jetë 777.3 përqind, duke qenë mbi normën e pranuar prej 100 përqind. Ndërsa, mbulueshmëria e provizioneve teknike me asete të pranueshme arriti në 110.4 përqind nga 108.6 përqind në fund të vitit 2023 për siguruesit jo-jetë, përderisa për siguruesit jetë zbriti në 114.9 përqind nga 115.0 përqind.


Niveli i likuiditetit të sektorit shënoi rënie të lehtë në krahasim me vitin paraprak. Raporti ndërmjet parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj ndaj rezervave zbriti në 95.4 përqind nga 96.3 përqind sa ishte në fund të qershorit 2023, si rezultat i rritjes vjetore më të ulët të parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj prej 12.0 përqind, krahasuar me rritjen më të lartë prej 13.1 përqind të rezervave teknike të sektorit të sigurimeve. Kurse, raporti ndërmjet parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj ndaj gjithsej detyrimeve mbeti në nivel të njëjtë me vitin paraprak prej 83.3 përqind.

4.4. Sektori mikrofinanciar

Asetet e sektorit mikrofinanciar arritën vlerën 590.9 milionë euro, rritje vjetore dukshëm më e përshpejtuar prej 32.1 përqind nga 20.2 përqind në TM2 2023. Ky zhvillim është ndikuar kryesisht nga rritja e lartë e aktivitetit kreditues dhe në masë më të vogël nga rritja e bilancit me bankat komerciale dhe lizingjet (grafiku 45). Megjithatë normat e interesit në tregjet ndërkombëtare nga financohet sektori mbetën të larta deri në qershor 2024 kur Banka Qendrore Evropiane mori vendim për ulje të normës baze të interesit, sektori rriti financimin nga jashtë. Në qershor 2024, huazimet (linjat kreditore) jashtë vendit shënuan rritje për 30.8 përqind. Po ashtu, kontribut në rritjen e aktivitetit të sektorit kishte edhe rritja e nivelit të kapitalit, nga fitimi i bartur ndër vite dhe atij të realizuar gjatë kësaj periudhe.


Kreditë e sektorit mikrofinanciar arritën në 396.5 milionë euro në fund të tremujorit të dytë të vitit, duke shënuar rritje vjetore prej 23.3 përqind, lehtësisht të përshpejtuar nga 23.1 përqind në vitin paraprak. Vlera e kredive për ekonomitë familjare arriti në 236.9 milionë euro, që paraqet rritje vjetore të përshpejtuar, përkatësisht rritje prej 17.5 përqind (grafiku 46). Kreditimi ndaj korporatave jo-financiare gjithashtu shënoi rritje vjetore të përshpejtuar në 32.9 përqind. Rritja e kredive ndaj KJF-ve u ndikua pozitivisht nga kreditimi në të gjithë

Grafik 45. Asetet e sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK.


Grafik 46. Mera e kredive ndaj ekonomive familjare dhe korporatave jofinanciare



Burimi: BQK.


sektorët ekonomik (grafiku 47). Rritje vjetore më të theksuar në kuadër të KJF-ve shënoi segmenti i tregtisë i cili arriti në 18.4 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 47.9 përqind. Rritja e lartë e këtij segmenti ndikoi që pjesëmarrja e tij në gjithsej kreditë ndaj KJF-ve të rritet për 1.2 pikë përqindje, duke arritur në 11.5 përqind. Vlera e kredive ndaj sektorit të bujqësisë arriti në 39.5 milionë euro, rritje vjetore të përshpejtuar, përkatësisht rritje prej 27.1 përqind. Megjithëse segmenti i bujqësisë vazhdon të ketë peshën më të madhe në gjithsej kreditë ndaj KJF-ve, krahasuar me periudhën e kaluar shënoi rënie të pjesëmarrjes në 24.8 përqind nga 25.9 përqind të gjithsej kredive të sektorit. Në rritje të kreditimit për sektorin e bujqësisë ndikim pozitiv vazhdon të ketë mbështetja e vazhdueshme e Fondit Kosovar për Garanci Kreditorë (FKGK) (grafiku 48).

Grafik 47. Vlera e kredive ndaj korporatave jofinanciare, sipas sektorëve të ekonomisë



Burimi: BQK.


Grafik 48. Kontributi në rritje të kreditimit ndaj korporatave jofinanciare, sipas sektorëve të ekonomisë



Burimi: BQK.

Lizingjet arritën vlerën 101.4 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore të përshpejtuar prej 26.8 përqind nga 14.5 përqind në vitin paraprak. Kontributin kryesor në rritjen e lizingjeve e kishin korporatat jo-financiare, të cilat shënuan rritje vjetore prej 39.5 përqind dhe kanë peshën më të lartë prej 70.6 përqind në gjithsej lizingjet. Ndërsa, kontributi i lizingjeve të ekonomive familjare ishte dukshëm më i ulët marrë parasysh peshën e tyre të ulët në kuadër të gjithsej lizingjeve dhe rritjen vjetore prej vetëm 4.2 përqind (grafiku 49).


Grafik 49. Vlera e lizingjeve të sektorit




Burimi: BQK.

Norma mesatare e interesit në kreditë e lëshuara nga mikrofinancat në qershor 2024 ishte 20.6 përqind, duke shënuar rritje prej 1.7 pikë përqindje krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Norma mesatare e interesit për ekonomitë familjare u karakterizua me rritje në 25.0 përqind nga 21.1 përqind, ndërsa kreditë për korporata jo-financiare u karakterizuan me rënie prej 0.2 pikë përqindje në 15.6 përqind. Rritje të normës së interesit shënuan kreditë konsumuese, nga 23.1 përqind në 24.5 përqind, ndërsa kreditë hipotekare shënuan rënie për 1.1 pikë përqindje duke zbritur në 15.9 përqind (grafiku 50). Norma mesatare e interesit për kreditë ndaj sektorit të bujqësisë shënoi rënie për 0.7 pike përqindje, duke zbritur në 17.1 përqind. Ndërsa, mesatarja e interesit në kreditë ndaj sektorit të industrisë dhe shërbimeve shënoi rritje për 0.4 dhe 0.3 pikë përqindje, duke arritur në 17.7 dhe 15.0 përqind, respektivisht (grafiku 51).

Grafik 50. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar




Grafik 51. Norma mesatare e interesit në kredi për ndërmarrje, sipas sektorëve ekonomik



Profiti neto i sektorit mikrofinanciar arriti në 9.9 milionë euro, rritje vjetore e përshpejtuar prej 22.2 përqind nga rënia prej 8.6 përqind në vitin paraprak. Të hyrat e sektorit arritën vlerën 42.7 milionë euro, apo rritje vjetore prej 35.8 përqind (grafiku 52). Kontributin kryesor në rritjen e të hyrave e kishte rritja e përshpejtuar vjetore e të hyrave nga interesi për 24.2 përqind nga 18.6 përqind në vitin e kaluar, kryesisht si rezultat i rritjes së lartë të kreditimit. Vlera e kësaj kategorie të hyrash arriti në 35.6 milionë euro, duke përfaqësuar 83.5 përqind të gjithë të hyrave. Të ardhurat nga jo-interesi arritën në 7.1 milionë euro, apo rritje për 4.3 milionë euro krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Rritja e theksuar e këtyre të hyrave është kryesisht si rrjedhojë e riklasifikimit të dy institucioneve financiare nga trajtimi si ndihmës financiarë në kategorizimin në kuadër të IMF/IFJB-ve⁶, që për aktivitet kryesor kanë shërbimet e pagesave. Kjo ka rezultuar në rritje të theksuar të nënkategorisë së të ardhurave nga jointerеси, pa afektuar të ardhurat nga interesi (pasi që këto institucione nuk lëshojnë kredi).

Grafik 52. Profiti dhe treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar



Shpenzimet shënuan rritje të theksuar prej 40.5 përqind nga 25.7 përqind rritje në vitin paraprak, duke arritur kështu vlerën 32.8 milionë euro. Në kuadër të shpenzimeve, rritje të theksuar ka shënuar kategoria e shpenzimeve nga interesi, duke arritur vlerën 10.6 milionë euro apo rritje vjetore prej 84.5 përqind nga një vit më parë. Rritja e nivelit dhe kostonë së huazimit nga jashtë është reflektuar në këtë rritje të theksuar të shpenzimeve nga interesi, meqenëse aktiviteti i sektorit mikrofinanciar e financon veprimtarinë në masën më të madhe nga këto huazime/linja kreditore (61.8 përqind të gjithë detyrimeve dhe kapitalit vetanak). Po

⁶ Në nëntor 2023, është bërë riklasifikimi i dy ndihmësve financiarë në ndërmjetës tjerë financiarë (IMF&IFJB).

ashtu, rritje ka shënuar edhe kategoria e shpenzimeve nga jo-interesi e cila arriti në 16.2 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 20.3 përqind. Kontributin kryesorë në këtë dinamikë e kishte rritja vjetore prej 17.2 përqind e shpenzimeve të personelit dhe administrative, të cilat arritën vlerën prej 15.0 milionë euro.


Raporti i kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive shënoi rritje vjetore të lehtë duke arritur në 1.9 përqind nga 1.8 përqind në qershor 2023. Vlera e kredive joperformuese ka arritur në 8.9 milionë euro nga 7.1 milionë në vitin paraprak. Niveli i mbulueshmërisë së kredive jo-performuese me provizione në qershor 2024 zbriti në 157.6 përqind nga 169.0 përqind (grafiku 53). Niveli i kredive joperformuese vazhdon të jetë më i lartë për IFJB-të kundrejt IMF-ve. Krahasuar me qershorin e vitit të kaluar, niveli i kredive jo-performuese për IFJB-ka mbetur në nivelin e njëjtë 2.8 përqind, ndërkohë që për IMF-të ka shënuar rritje nga 1.5 përqind në 1.7 përqind (grafiku 54).

4.5. Tregu i letrave me vlerë i Qeverisë së Republikës së Kosovës

Letrat me vlerë të emetuara gjatë tremujorit të dytë të vitit 2024 arritën shumën prej 93.2 milionë euro, për dallim nga tremujori i dytë i vitit paraprak kur nuk u emetua asnjë letër me vlerë (grafiku 54). Sidoqoftë, raporti i borxhit të brendshëm ndaj Bruto Produktit Vendor (BPV) shënoi rënie në 9.06 përqind në qershor 2024 nga 10.05 përqind në periudhën e njëjtë në vitin paraprak, si rezultat i shkallës më të lartë të rritjes së BPV-së në raport me emetimet të cilat ishin në nivel më të ulët se vlera e maturimeve. Kërkesa e akterëve në treg për të investuar në letra me vlerë ka tejkaluar ofertën e qeverisë, për 1.26 herë në këtë tremujor (grafiku 56).


Mbajtësit e letrave me vlerë qeveritare vazhdojnë të udhëhiqen nga fondet pensionale që përbëjnë 48 përqind të stokut të borxhit qeveritar, pasuar nga bankat komerciale me 22 përqind, institucionet publike me 21 përqind dhe kompanitë e sigurimit që përbëjnë 6 përqind të stokut të borxhit. Pjesa e mbetur prej 3 përqind mbahen nga investitor të tjerë.

Grafik 53. Treguesit e kualitetit të portfolios kreditorë




Burimi: BQK.

Grafik 54. Niveli i kredive joperformuese për IMF-të dhe IFJB-të.




Burimi: BQK.

Grafik 55. Shuma dhe maturiteti i borxhit të emetuar, ndryshimi vjetor




Burimi: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Grafik 56. Shuma e ofruar dhe emetuar



Burimi: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Grafik 57. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë, në përqindje



Burimi: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Stoku i borxhit të brendshëm të qeverisë së Kosovës në formë të letrave me vlerë, të mbajtur nga investuesit si bankat, fondet pensionale, institucionet publike dhe kompanitë e sigurimit zbriti në 956.3 milionë euro në fund të qershorit 2024 nga 970.2 milionë euro në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Struktura e letrave me vlerë sipas afatit të maturimit ndër vite ka pësuar ndryshime graduale, duke u zgjeruar drejt afateve më të gjata të maturimit. Në periudhën janar-qershor 2024, struktura u dominua nga fletë-obligacionet qeveritare me maturitet 3 vjeçar, që përbëjnë rreth 40.4 përqind të emetimeve të reja, pasuar nga ato me maturitet prej 5 dhe 7 viteve’ (grafiku 57).

Citimi i sugjeruar i këtij publikimi:

BQK: Vlerësimi Tremujor i Ekonomisë nr. 47, TM2 2024, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Referencat:

BQK:

- a) Buletini Mujor Statistikor: Buletini Mujor Statistikor | Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (bqk-kos.org)
- b) Statistikat zyrtare të BQK-së, Seritë kohore: Seritë Kohore | Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (bqk-kos.org)

ASK:

- a) Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit: <https://ask.rks-gov.net/>
- b) Indeksi i çmimeve të prodhimit: <https://ask.rks-gov.net/>
- c) Indeksi i çmimeve të importit: <https://ask.rks-gov.net/>
- d) Indeksi i kostos së ndërtimit: <https://ask.rks-gov.net/>
- e) Repertori Statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike: <https://ask.rks-gov.net/>
- f) Statistikat e tregtisë së jashtme: <https://ask.rks-gov.net/>

Të tjera:

- a) Shpalljet dhe Rezultatet e ankandeve për letra me vlerë të qeverisë: <https://mf.rks-gov.net/>
- b) Fondi Kosovar për Garanci Kreditorë: <http://fondikgk.org/>
- c) Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës: Ballina | FKPK (trusti.org)
- d) Ministria e Financave Punës dhe Transfereve - Të dhënat nëntëmujore mbi borxhin shtetëror dhe garantitë shtetërore: <https://mfpt.rks-gov.net/desk/content/media/5dd2850a-be21-4e50-8860-9df088b1c540.pdf>
- e) Ministria e Financave Punës dhe Transfereve - Raport Nëntëmujor Financiar, Buxheti i Republikës së Kosovës: <https://mfpt.rks-gov.net/desk/content/media/6d90a295-b45d-42c7-9982-242354d26b5a.pdf>

Euribor: Euribor Historical Rates: <http://www.euribor-ebf.eu/euribor-org/euribor-rates.html>

ECB (BQE): Economic Bulletin Research & Publications (europa.eu); Key ECB interest rates (europa.eu)

FAO: Home | Food and Agriculture Organization of the United Nations (fao.org)

IMF (FMN): International Monetary Fund (IMF)

World Economic Outlook: World Economic Outlook (imf.org)

World Bank: Commodity Markets: Commodity Markets (www.worldbank.org)



Rr. Garibaldi, nr. 33, 10000 Prishtinë,
Republika e Kosovës
Tel Tel: +383 38 222 055; Fax: +383 38 243 763
Web: www.bqk-kos.org